

# HULUMTIM KRAHASUES I SISTEMEVE ZGJEDHORE



GJETJET FILLESTARE NACIONALLE PËR  
REPUBLICËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË  
LIDHJE ME ZGJEDHJET E PRILLIT DHE MAJIT 2024

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup,  
Institutit për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike

## HULUMTIM KRAHASUES I SISTEMEVE ZGJEDHORE

Gjetjet fillestare nacionale për Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me zgjedhjet e prillit dhe majit 2024

**Autorë:** Doc. Dr. Jovan Bliznakovski, Prof. Dr. Aneta Cekiq

**Ekipi hulumtues:** Doc. Dr. Jovan Bliznakovski, Prof. Dr. Aneta Cekiq, Mr. Luan Imeri, Safet Ballazhi

### Botues:



Instituti për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike,  
Universiteti "Shën Kiril dhe Metod" në Shkup (IHSPJ - UKM)  
Bul. Partizanski odredi pn. 1020 Shkup, Kutia postare 68, Republika  
e Maqedonisë së Veriut

[contact@isppi.ukim.edu.mk](mailto:contact@isppi.ukim.edu.mk) | <http://www.isppi.ukim.edu.mk>

### Partnerët:



Instituti për demokraci "Societas civilis" Shkup (IDSCS)  
Miroslav Krlezha 52/2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së  
Veriut

[contact@idscs.org.mk](mailto:contact@idscs.org.mk) | [www.idscs.org.mk](http://www.idscs.org.mk)



Programi zviceran për mbështetjen e zgjedhjeve në  
Maqedoninë e Veriut\*  
Franklin Ruzvelt, 19/1-5, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së  
Veriut

[ifes.mk@ifes.org](mailto:ifes.mk@ifes.org) | <https://electoralsupportprogramme.mk/>



\* Programi zviceran për mbështetje të zgjedhjeve zbatohet nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES).

*Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e donatorëve IHSPJ-UKM, IDSCS, dhe Programit zviceran për mbështetjen e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.*

# Përmbajtja

Lista e grafikëve.....	3
Lista e tabelave.....	5
Hyrje .....	6
Informata teknike në lidhje me anketën dhe mostrën .....	8
Dalshmëria dhe vendimi zgjedhor .....	10
Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 .....	10
Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 .....	11
Vendimet zgjedhore në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 – Raundi i parë .....	13
Vendimet zgjedhore në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 – Raundi i dytë .....	14
Vendimet zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024.....	16
Ndryshimet në votim midis vitit 2020 dhe 2024.....	19
Formimi i vendimeve zgjedhore .....	21
Arsyet e zgjedhjes së votës .....	21
Koha e vendimit zgjedhor .....	25
Shkaqet e abstenimit .....	26
Perceptimet për vendimin zgjedhor personal.....	28
Perceptimet për ofertën zgjedhore.....	29
Frekuenca e votimit për të njëjtin opSION politik.....	30
Fushata zgjedhore .....	32
Pjesëmarrja qytetare në fushatën zgjedhore .....	32
Burimet e informimit gjatë fushatës.....	34
Klientelizmi zgjedhor.....	35
Lidhje midis partive dhe qytetarëve .....	37
Afërsia me partitë .....	37
Anëtarësia në parti politike .....	38
Afekte ndaj partive politike dhe liderëve.....	39
Perceptimet për vlerat që përfaqësojnë partitë .....	40
Perceptimet për profilin ideologjik të partive.....	42
(Mos) kënaqësia me demokracinë dhe institucionet.....	44
Perceptimet për zbatimin e demokracisë .....	44
Perceptimet për efikasitetin e rendit demokratik .....	45
Besimi në institucione dhe aktorët kryesorë socialë.....	47
Perceptimet për procesin zgjedhor .....	48
(Mos)kënaqësia me performancën e qeverisë (2020-2024) dhe çështjet aktuale në vigjilje të zgjedhjeve .....	49
Preferencat ideologjike dhe të vlerave të qytetarëve .....	53
Vetë pozicionimi majtas përkundër djathtas.....	53

Pikëpamje mbi barazinë gjinore.....	54
Mbështetje për rendin politik demokratik.....	56
Kush ta udhëheqë vendin në vend të politikanëve të zgjedhur? .....	57
Predispozitat qytetare për pjesëmarrje politike .....	58
Interesi për politikën .....	58
Perceptimet për efikasitetin politik personal (të brendshëm) .....	59
Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve.....	61
Frekuenca e votimit në zgjedhje .....	62

# Lista e grafikëve

Grafiku 1. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024.....	10
Grafiku 2. Pjesëmarrja në zgjedhjet presidenciale, sipas rajonit.....	10
Grafiku 3. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale, sipas përkatësisë etnike .....	11
Grafiku 4. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale, sipas moshës .....	11
Grafiku 5. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024.....	12
Grafiku 6. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajonit.....	12
Grafiku 7. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës .....	13
Grafiku 8. Për kë keni votuar në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024?..	13
Grafiku 9. Vendimi zgjedhor në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, sipas rajoneve	14
Grafiku 10. Për kë keni votuar në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024?	15
Grafiku 11. Vendimi zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, sipas moshës	15
Grafiku 12. Vendimi zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, sipas përkatësisë etnike .....	16
Grafiku 13. Për kë keni votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024? .....	16
<i>Grafiku 14. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajoneve.....</i>	<i>17</i>
Grafiku 15. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas vendbanimit ...	17
<i>Grafiku 16. Vendimi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës.....</i>	<i>18</i>
Grafiku 17. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike .....	19
Grafiku 18. Mbështetja e votuesve në vitin 2024 sipas votimit në vitin 2020, zgjedhjet parlamentare.....	20
Grafiku 19. Arsyeja e zgjedhjes së një kandidati/e presidencial/e* .....	21
Grafiku 20. Arsyeja e zgjedhjes së një kandidati/e presidencial/e, sipas përkatësisë etnike* .....	22
Grafiku 21. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024* .....	23
Grafiku 22. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajonit* .....	24
Grafiku 23. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike* .....	25
Grafiku 24. Koha e vendimit zgjedhor* .....	25
Grafiku 25. Koha e vendimit zgjedhor, sipas rajonit* .....	26
Grafiku 26. Arsyet e abstenimit nga votimi* .....	26
Grafiku 27. Vendimet për abstenim në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës*	27
Grafiku 28. Vendimet për abstenim në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike* .....	28
Grafiku 29. Kënaqësia me vendimin zgjedhor .....	28
Grafiku 30. Kënaqësia me ofertën zgjedhore .....	29
Grafiku 31. Kënaqësia me ofertën zgjedhore, sipas rajonit .....	29
Grafiku 32. A votoni për të njëjtën parti në të gjitha zgjedhjet?*	30
Grafiku 33. Votimi për të njëjtën parti, sipas rajonit* .....	30
Grafiku 34. Votimi për të njëjtën parti, sipas përkatësisë etnike* .....	31
Grafiku 35. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese të partive gjatë fushatës* .....	32
Grafiku 36. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese, sipas gjinisë* .....	33
Grafiku 37. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese, sipas përkatësisë etnike* .....	33
Grafiku 38. Mediat e përdorura gjatë fushatës me qëllim ndjekjen e lajmeve, në baza javore .....	34
Grafiku 39. Përqindja e të anketuarve që kanë ndjekur lajmet çdo ditë gjatë gjithë fushatës, sipas grup moshës dhe mediave.....	35

Grafiku 40. Përçindja e të anketuarve që nuk kanë ndjekur kurrë lajme gjatë fushatës, sipas grup moshës dhe medias.....	35
Grafiku 41. Përvojë me klientelizmin zgjedhor* .....	36
Grafiku 42. Perceptimi për afërsinë personale me një parti të caktuar politike.....	37
Grafiku 43. Cilën parti e ndieni më të afërt? .....	37
Grafiku 44. Shkalla e afërsisë me partinë e përzgjedhur .....	38
Grafiku 45. Anëtarësia në parti sipas rajonit* .....	38
Grafiku 46. Anëtarësia në parti sipas grup moshës* .....	38
Grafiku 47. Frekuenca e pjesëmarrjes në aktivitetet e partisë* .....	39
Grafiku 48. Afekte ndaj partive politike dhe koalicioneve.....	40
Grafiku 49. Afekte ndaj liderëve politikë dhe një pjesë të kandidatëve presidencialë.....	40
Grafiku 50. Vlerat më të rëndësishme për partinë për të cilën kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024* .....	41
Grafiku 51. Përçindja e të anketuarve që nuk dinë të pozicionojnë ideologjikisht partinë ....	42
Grafiku 52. Perceptimi ideologjik i partive.....	43
Grafiku 53. Sa demokratike është Maqedonia e Veriut?.....	44
Grafiku 54. Kënaqësia me procesin demokratik .....	45
Grafiku 55. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor? .....	45
Grafiku 56. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor? (sipas rajonit) .....	46
Grafiku 57. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor? (sipas përkatësisë etnike) .....	46
Grafiku 58. Sa trajtohen në mënyrë të barabartë grupet e ndryshme shoqërore? .....	47
Grafiku 59. Sa trajtohen në mënyrë të barabartë grupet e ndryshme shoqërore? (sipas përkatësisë etnike) .....	47
Grafiku 60. Besimi në institucionet dhe aktorët kryesorë socialë .....	48
Grafiku 61. Perceptimet për drejtësinë e zgjedhjeve .....	49
Grafiku 62. Perceptimet për efikasitetin e zgjedhjeve.....	49
Grafiku 63. Perceptimet e punës së Qeverisë (2020-2024).....	50
Grafiku 64. Perceptimet për performancën e partnerëve të koalicionit qeveritar 2020-2024* .....	50
Grafiku 65. Perceptimet e situatës ekonomike në 12 muajt e fundit .....	51
Grafiku 66. Perceptimet e situatës ekonomike në 12 muajt e fundit, sipas rajonit.....	51
Grafiku 67. Perceptimet për efektet e pandemisë.....	52
Grafiku 68. Vetë pozicionimi në shkallë majtas-djathtas.....	53
Grafiku 69. Shkalla ideologjike majtas-djathtas, tatimet dhe shërbimet sociale* .....	54
Grafiku 70. Pikëpamjet mbi përfaqësimin e grave në Kuvend .....	54
Grafiku 71. Pikëpamjet nëse burrat apo gratë janë më të përshtatshëm për të udhëhequr në kohë krize .....	55
Grafiku 72. Mbështetje për rendin politik demokratik.....	56
Grafiku 73. Kush ta udhëheqë vendin në vend të politikanëve të zgjedhur? .....	57
Grafiku 74. Interesi për politikën.....	58
Grafiku 75. Interesi për politikën sipas gjinisë .....	58
Grafiku 76. Interesi për politikën, sipas grup moshës .....	59
Grafiku 77. Efikasiteti politik i brendshëm.....	59
Grafiku 78. Efikasiteti politik i brendshëm, sipas gjinisë.....	60
Grafiku 79. Efikasiteti politik i brendshëm, sipas grup moshës .....	60
Grafiku 80. Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve* .....	61
Grafiku 81. Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve, sipas rajonit* .....	61
Grafiku 82. Frekuenca e votimit në zgjedhje* .....	62

## **Lista e tabelave**

Tabela 1. Struktura e mostrës së realizuar.....	9
Tabela 2. Vlerat më të rëndësishme të partive/koalicioneve (qëndrimet e votuesve)* .....	42

# Hyrje

Gara zgjedhore në prill dhe maj 2024 rezultoi në ndryshime të rëndësishme në skenën politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përbërja partiake dhe e personelit të institucioneve legjislative dhe ekzekutive u ndryshua në mënyrë gjithëpërfshirëse. Edhe sistemi partiak ka pësuar një transformim drejt rritjes së rëndësisë së opsioneve më të vogla politike. Partitë politike që deri para do kohe ishin parti qeverisëse pritën fundin e procesit zgjedhor me mbështetje dukshëm të zvogëluar në mesin e popullatës dhe me ndryshime kadrovike në krye, për njërin parti, si dhe me largimin në opozitë pas më shumë se një dekade e gjysmë, për tjetrën. Në përgjithësi, zgjedhjet e vitit 2024 demonstuan një mosmiratim të fortë ndaj punës së qeverisë së mëparshme, si dhe një gatishmëri të shtuar për të mbështetur partitë, koalicionet dhe kandidatët që nuk u përkasin partive politike të etabluara. Kjo dinamikë vë në fokus sjelljen zgjedhore të qytetarëve, si një faktor i rëndësishëm që përcakton në një farë mase rezultatet zgjedhore dhe politike.

Megjithatë, sjellja zgjedhore e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut deri më tani pak është ndjekur në mënyrë sistematike. Megjithëse në vend kryen rregullisht sondazhe që synojnë raportimin e rejtingut të partive dhe kandidatëve në periudhën parazgjedhore, si dhe sondazhe "omnibus" dhe hulumtime për çështje specifike që prekin pjesërisht sjelljen zgjedhore, në vitet e fundit nuk ka të dhëna të disponueshme të sondazheve që përqendrohen ekskluzivisht në sjelljen e qytetarëve në periudhën zgjedhore. Ky raport është një përpjekje për të paraqitur të dhëna të tilla për publikun, me dy objektiva të përgjithshme: 1. të informojë aktorët kryesorë në fushën e politikave zgjedhore për tendencat në sjelljen zgjedhore; 2. të njohë publikun profesional me mundësitë për ripërdorimin e të dhënave të anketës që do të jenë në dispozicion në qasje të hapur në të ardhmen. Raporti përpiket të ofrojë gjetje mbi pyetjen e gjerë se pse qytetarët votuan në mënyrën si votuan në prill dhe maj 2024, duke paraqitur një sërë treguesish të sjelljes zgjedhore që mund të jenë me interes si për grupet e lartpërmendura ashtu edhe për publikun e gjerë.

Të dhënat e sondazhit dhe raporti që del prej tyre është fryt i bashkëpunimit të Institutit për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (IHSPJ-UKM), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" nga Shkupi (IDSCS) dhe Programi zviceran për mbështetje zgjedhore në Maqedoninë e Veriut, zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES). Këto tre organizata, njëra prej të cilave vjen nga sektori publik i hulumtimit dhe arsimit të lartë, ndërsa dy të tjerat nga sektori civil, kombëtar dhe ndërkombëtar, në fillim të vitit 2024 krijuan bashkëpunim me qëllim zbatimin e modulit të gjashtë të Hulumtimit krahasues të sistemeve zgjedhore (HKSZ, Comparative Study of Electoral Systems, CSES, <https://ces.org/>). Hulumtimi u mbështet gjithashtu nga Fondacioni Kombëtar i Shkencës i SHBA-së, në kuadër të Programit për HKSZ-e grante fillestare. Puna në terren për sondazhin u krye kah fundi i vitit 2024.

HKSZ-ja është sondazh hulumtues ndërkombëtar, i koordinuar nga Qendra për studime politike në Universitetin e Miçiganit, SHBA dhe GESSIS - Institutit për shkencë sociale "Leibniz", Gjermani, i cili përqendrohet në sjelljen zgjedhore të qytetarëve. Deri më tani, është zbatuar në 60 vende të botës në pesë valë të ndryshme, duke filluar nga viti 1996. Me zbatimin e HKSZ-së, vendi pas një periudhe më të gjatë merr të dhëna të sondazhit të përqendruara ekskluzivisht në sjelljen zgjedhore të qytetarëve dhe mundësinë për të krahasuar rrethanat e veta zgjedhoreme demokracitë e tjera në mbarë botën. Baza e të dhënave e krijuar pas anketës në terren në Maqedoninë e Veriut do të depozitohet në HKSZ, gjatë vitit 2025 dhe do të jetë në dispozicion nën qasje të hapur së bashku me të dhënat nga vendet e tjera pjesëmarrëse në modulën e gjashtë.

Çfarë përfundojmë pas shqyrtimit fillestar të të dhënave? Pakënaqësia e përgjithshme me partitë në pushtet në periudhën 2020-2024 identifikohet lehtësisht në zgjedhje, perceptimet për situatën e përgjithshme, perceptimet për punën e partive politike dhe lidhjen afektive me to. Një numër i madh i qytetarëve votojnë në mënyrë të përsëritur, si në lidhje me



dalshmerinë ashtu edhe për sa u përket zgjedhjeve votuese specifike. Por një pjesë e konsiderueshme e tyre vendosin se për kë do të votojnë edhe gjatë fushatës. Qytetarët janë të ndarë për sa i përket arsyeve të dhënies së votës së tyre: disa votojnë për shkak të programit të partisë dhe brendit të partisë politike, ndërsa për të tjerët janë të rëndësishme karakteristikat personale të kandidatëve dhe pikëpamjet që ata përfaqësojnë. Është theksuar identifikimi etnik me partitë dhe kandidatët, megjithëse ka edhe shembuj të kalimit të barrierave etnike, si dhe dallime të konsiderueshme rajonale dhe dallime midis grup moshave në të gjitha aspektet e mësipërme.

Një numër relativisht i madh qytetarësh marrin pjesë në jetën politike përmes anëtarësimit në parti dhe rrjedhimisht në aktivitetet partiake. Një numër i konsiderueshëm qytetarësh morën pjesë gjithashtu në aktivitetet e fushatës së partive dhe një numër i konsiderueshëm treguan interes për aktualitetet e fushatës, duke ndjekur lajmet për partitë dhe kandidatët.

Qytetarët janë shumë kritikë ndaj zbatimit të demokracisë në vend, dhe siç tregohet shpesh edhe në sondazhet e tjera, kanë besim të ulët tek institucionet dhe aktorët politikë. Megjithatë, qytetarët në përgjithësi demonstrojnë mbështetje për parimet demokratike dhe i shohin zgjedhjet kryesisht si një mjet të rëndësishëm për ndikim politik.

Shqyrtimi ynë fillestar i të dhënave gjithashtu zbulon më shumë plasaritje në shoqëri që kanë efekte në sjelljen zgjedhore. Ndarja etnike është një nga më të theksuarat: ajo strukturon zgjedhjen votuese, veçanërisht te maqedonasit dhe shqiptarët, dhe është gjithashtu relevante për sa i përket pjesëmarrjes më të ulët të anëtarëve të bashkësive të tjera etnike në disa nga treguesit e matur të pjesëmarrjes politike. Përveç kësaj, regjistrojmë një pjesëmarrje dukshëm të ulët të grup moshës më të re (18-24 vjeç) përmes disa proceseve demokratike, si dhe njëfarë dominimi të burrave në jetën politike. Gratë dhe të rinjtë janë më pak të interesuar në politikë, kanë besim më të ulët në aftësinë e tyre për pjesëmarrje politike dhe paralelisht marrin pjesë më pak në aktivitete partiake dhe në fushata, duke sugjeruar një përfaqësim më të ulët sistemik të këtyre grupeve në procesin politik.

Ky raport është vetëm një analizë fillestare e të dhënave. Gjatë vitit 2025, do të përgatitet një raport tjetër hulumtues, i cili do të ketë për qëllim t'ia paraqesë publikut të dhënat krahasuese midis Maqedonisë së Veriut dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse në HKSZ.

Raporti është strukturuar në mënyrën vijuese. Para së gjithash, paraqesim informata teknike në lidhje me hulumtimin. Pastaj, kalojmë në paraqitjen e gjetjeve fillestare, të cilat grupohen në temat e mëposhtme: dalshmëria dhe vendimi zgjedhor ; formimi i vendimeve zgjedhore; fushata zgjedhore; lidhjet midis partive politike dhe qytetarëve; (pa) kënaqësia me demokracinë dhe institucionet; preferencat ideologjike dhe të vlerave të qytetarëve; dhe predispozitat qytetare për pjesëmarrje politike. Për secilën nga temat e listuara, paraqesim më shumë gjetje dhe indikatorë.

# Informata teknike në lidhje me anketën dhe mostrën

Puna në terren për sondazhin u krye në periudhën 25 tetor – 4 dhjetor 2024, duke filluar para skadimit të gjashtë muajve pas zgjedhjeve të zhvilluara, në përputhje me standardet e HKSZ-së. Pyetëtori ishte i përbërë nga moduli HKSZ (afërsisht një e treta e pyetësorit) dhe pyetje shtesë me interes për tre organizatat që kryen sondazhin (rreth gjysma e pyetësorit), si dhe një modul demografik (10% e pyetësorit). Kohëzgjatja mesatare e zbatimit të pyetësorit të plotë është afërsisht 30 minuta. Puna në terren u krye nga “Indago” – Shkup, përmes sondazheve ballë për ballë me asistimkompjuterik, në gjuhën maqedonase dhe shqip. Ky raport paraqet rezultatet e pyetjeve në kuadër të modulit të HKSZ, si dhe pyetjet e parashtruara nga hulumtuesit e IHSPJ-UKM.

Sondazhi u zbatua në bazë të një mostre të stratifikuar shumëfazore, bazuar në adresat dhe të përgatitur nga Enti shtetëror për statistika (ESHS), duke përdorur të dhënat nga Regjistrimi i fundit i popullsisë, familjeve dhe banesave (2021). Gjatë shtresëzimit, u morën parasysh shpërndarjet e popullsisë sipas rajoneve planifikuese dhe sipas ndarjes urbane dhe rurale, pas së cilës u tërhoqën në mënyrë të rastësishme gjithsej 188 njësi zgjedhore (njësi primare të mostrës). Në fazën e dytë të përzgjedhjes, 10 adresa u zgjedhën rastësisht brenda këtyre njësive zgjedhore, duke krijuar një mostër prej gjithsej 1880 adresash banimi (njësi dytësore të mostrës). Secila prej këtyre adresave u vizitua nga anketuesit e anketës me ofertë sondazhi, me gjithsej 1056 sondazhe të kryera (ose një normë përgjigjeje prej 56.2%). Në fazën e tretë të përzgjedhjes, të anketuarit në familje u përzgjedhën gjithashtu në mënyrë të rastësishme, sipas parimit të “ditëlindjes së parë të ardhshme”. Struktura e mostrës sipas rajonit, vendbanimit, gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike është në dispozicion në Tabelën 1.

Gjetjet që vijojnë rrjedhin nga statistikat përshkruese: paraqesim frekuencat dhe mesataret e përgjigjeve të sondazhit të siguruara dhe i përmbledhim tendencat kryesore. Të dhënat e paraqitura peshohen me ponderim post-stratifikimi të krijuar për të korrigjuar mospërputhjet e mundshme midis strukturës së popullsisë dhe mostrës së realizuar. Kudo përgjatë raportit ku paraqiten dhe komentohen dallime midis grupeve të caktuara, paraqesim vetëm dallimet që përmes procedurave adekuate është vërtetuar se janë të rëndësishme statistikisht, përkatësisht dallimet ndërmjet grupeve që mund të konsiderohen sistematike. Kombinojmë prezantimin grafik dhe narrativ të gjetjeve të perceptuara fillimisht.

Raporti përmban gjetje nga pyetëtori nga Moduli 6 i HKSZ dhe pyetje shtesë të formuluar nga IHSPJ-UKM (përgjatë raportit, të shënuara me yll - \*).

Tabela 1. Struktura e mostrës së realizuar


		Numri	Përqind
Totali		1056	100.0%
Rajoni	I Shkupit	300	28.4%
	Lindor	74	7.0%
	Juglindor	112	10.6%
	Verilindor	69	6.5%
	I Pellagonisë	139	13.2%
	I Vardarit	89	8.4%
	Jugperëndimor	109	10.3%
	I Pollogut	164	15.5%
Vendbanimi	Qyteti	566	53.6%
	Fshat	490	46.4%
Gjinia	Meshkuj	544	51.5%
	Femra	512	48.5%
Mosha	18-24	63	6.0%
	25-34	142	13.4%
	35-44	206	19.5%
	45-54	229	21.7%
	55-64	163	15.4%
	65+	253	24.0%
Përkatësia etnike	Maqedonas	682	64.6%
	Shqiptar	294	27.8%
	Tjetër	80	7.6%

# Dalshmëria dhe vendimi zgjedhor

## Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024


Dalshmëria është një komponent i rëndësishëm i procesit zgjedhor që mund të ndryshojë në varësi të llojit të zgjedhjeve. Sipas rezultateve të këtij sondazhi, 74% e të anketuarve në mostrën tonë kanë votuar në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, ndërsa në raundin e dytë pjesëmarrja u ul me rreth 10% në 64% (Grafiku 1).

Grafiku 1. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024



Ka dallime të konsiderueshme në pjesëmarrjen në raundin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve presidenciale për sa u përket rajoneve dhe përkatësisë etnike, të cilat në këtë rast mbivendosen disi, si dhe sipas vendbanimit dhe gjinisë. Në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, një përqindje më e lartë e qytetarëve nga rajoni i Vardarit (90%), Rajoni Lindor (85%), i Pellagonisë (82%) votuan, ndërsa pjesëmarrja më e ulët ishte në rajonin e Pollogut (64%) dhe rajonin Verilindor (65%) (Grafiku 2). Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, qytetarët nga rajoni i Pollogut (33%), rajoni Verilindor (57%) dhe rajoni Jugperëndimor (59%) votuan dukshëm më pak.


Grafiku 2. Pjesëmarrja në zgjedhjet presidenciale, sipas rajonit



Sipas përkatësisë etnike, në të dy raundet zgjedhore dalshmëria më e madhe është e maqedonasve (80% dhe 75%), pasuar nga shqiptarët, ku dalshmëria midis raundit të parë


dhe të dytë bie me 25%, përkatësisht nga 65% në 40%. Në grupin e përbërë nga të anketuarit nga bashkësitë e tjera etnike, dalshmëria ishte 58% dhe 56%, për raundin e parë dhe të dytë përkatësisht (Grafiku 3).

Grafiku 3. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale, sipas përkatësisë etnike



Në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, votuan një përqindje më e lartë e burrave (77%) krahasuar me gratë (71%), ndërsa në raundin e dytë nuk kishte dallime të tilla. Ekzistojnë gjithashtu dallime sipas moshës së subjekteve (Grafiku 4). Dalshmëria në raundin e parë të zgjedhjeve është më e larta në mesin e grup moshës 45-54 vjeç (81%), ndërsa të anketuarit më të rinj (18-24 vjeç) kanë një dalshmëri bindshëm më të ulët prej 50%. Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, dalshmëria e të anketuarve më të rinj ishte edhe më e ulët, me vetëm 39%. Në raundin e dytë, përsëri dalshmëria është më e lartë në grup moshën 45-54 vjeç (72%) dhe të anketuarit më të moshuar – mbi 65 vjeç (71%). Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, përqindja e votuesve midis popullsisë rurale (58%) është gjithashtu më e ulët krahasuar me popullsinë urbane (68%).

Grafiku 4. Dalshmëria në zgjedhjet presidenciale, sipas moshës




## Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024

Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 e të anketuarve nga kjo mostër ishte 73% (Grafiku 5). Sipas rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, dalshmëria në zgjedhjet


parlamentare të vitit 2024 është më e lartë se dalshmëria në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, megjithëse të dy zgjedhjet u zhvilluan në të njëjtën ditë.

Grafiku 5. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024




Dalshmëria më e ulët është regjistruar midis qytetarëve të Rajonit verilindor (65%), Jugperëndimor (65%) dhe rajonit të Pollogut (66%), ndërsa më e madhja është në rajonin e Vardarit (92%), si dhe në rajonin e Pellagonisë (80%), Rajonin Lindor (79%) dhe rajonin Juglindor (78%) (Grafiku 6). Maqedonasit (78%) kanë një dalshmëri më të lartë se shqiptarët (67%) dhe grupi i përbërë nga bashkësitë e tjera etnike (59%).

Grafiku 6. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajonit



Dalshmëria relativisht e ulët e grup moshës më të re është gjithashtu mbresëlënëse për sa i përket zgjedhjeve parlamentare. Vetëm 49% e të anketuarve të moshës 18-24 vjeç votuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, krahasuar me mbi 70% në grup moshat e tjera (Grafiku 7). Dalshmëria më e lartë është në grup moshat 35-44 vjeç dhe 45-54 vjeç dhe është rreth 80%.


Grafiku 7. Dalshmëria në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës



## Vendimet zgjedhore në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 – Raundi i parë

Deri në 24% e të anketuarve në këtë mostër nuk iu përgjigjën pyetjes se për kë votuan në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale (Grafiku 8). Shumica, një e treta (34%), votuan për Gordana Siljanovska-Davkova, 14% për Stevo Pendarovskin, 11% për Bujar Osmanin, 7% për Arben Taravarin, 4% për Maksim Dimitrievskin, 3% për Biljana Vankovska-Cvetkovska dhe më pak se 1% për Stevço Jakimovskin. Pak më shumë se 2% kanë hedhur flet votim të pavlefshëm.

Grafiku 8. Për kë keni votuar në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024?




Siljanovska-Davkova dhe Pendarovski fituan përqindjen më të madhe të votave sipas rajonit, në rajonin e Vardarit (përkatësisht 52% dhe 25%) dhe rajonin Juglindor (përkatësisht 42% dhe 28%), dhe Siljanovska-Davkova gjithashtu kishte mbështetje të konsiderueshme në rajonin e Pellagonisë (37%), rajonin e Shkupit (37%) dhe rajonin Lindor (35%) (Grafiku 9). Osmani kishte më shumë mbështetje në rajonin Jugperëndimor (27%) dhe rajonin e Pollogut

(26%), ndërsa Taravari në rajonin e Pollogut (27%). Nga ana tjetër, mbështetja për Taravarin në rajonin Jugperëndimor është shumë më e ulët (vetëm 4%). Osmani dhe Taravari kishin mbështetje prej 13% dhe 10% përkatësisht në rajonin e Shkupit. Dimitrievski kishte mbështetjen më të madhe në rajonin Verilindor (17%), ndërsa Vankovska-Cvetkovska kishte mbështetjen më të madhe në rajonin e Vardarit (8%).

Sipas vendbanimit, dallimet statistikiqsh të rëndësishme tregojnë se Pendarovski dhe Dimitrievski kanë mbështetje më të madhe në qytete (16% dhe 5%) krahasuar me fshatrat (11% dhe 2%). Osmani dhe Taravari kanë më shumë mbështetje në fshatra (20% dhe 11%) krahasuar me qytetet (6% dhe 4%). Mbështetja për kandidatët e tjerë shpërndahet në mënyrë më të barabartë. Për sa i përket gjinisë, ka dallime midis burrave dhe grave vetëm në raport me kandidatin Dimitrievski, për të cilin votuan më shumë gra: 6%, krahasuar me 2% burra.

Grafiku 9. Vendimi zgjedhor në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, sipas rajoneve




## Vendimet zgjedhore në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 – Raundi i dytë

Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, 47% e të anketuarve në këtë mostër votuan për Siljanovska-Davkova dhe 23% për Pendarovski (Grafiku 10). Rreth 4% kanë hedhur fletëvotim të pavlefshëm ndërsa 25% nuk pranojnë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.


Mbështetjen më të madhe Siljanovska-Davkova e kishte në rajonin e Vardarit (60%) dhe Shkupit (53%), ndërsa Pendarovski në rajonin e Shkupit (29%) dhe rajonin juglindor (29%), krahasuar me rajonet e tjera. Siljanovska-Davkova ka mbështetjen më të madhe brenda një grup moshe, midis grupit më të vjetër të qytetarëve (65+) - 59% (Grafiku 11). Shumica e të anketuarve nga grup mosha më e re (18-24 vjeç) kanë hedhur fletëvotim të pavlefshëm (14%). Nuk ka dallime statistikiqsh të rëndësishme gjatë përzgjedhjes së një kandidati/e midis burrave dhe grave.



Grafiku 10. Për kë keni votuar në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024?




Grafiku 11. Vendimi zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, sipas moshës



Anëtarët e bashkësisë etnike shqiptare votuan për Pendarovskin (42%) më shumë se maqedonasit (20%) dhe anëtarët e bashkësive të tjera etnike (19%) (Grafiku 12). Maqedonasit (54%) dhe komunitetet e tjera etnike (44%) mbështetën dukshëm më shumë Siljanovska-Davkova në krahasim me shqiptarët (17%). Shqiptarët në përqindjen më të madhe të të gjitha grupeve etnike hodhën fletëvotim të pavlefshëm në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale (9%).


Grafiku 12. Vendimi zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, sipas përkatësisë etnike



## Vendimet zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024

Një e treta (34%) e të anketuarve në këtë mostër në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 votuan për koalicionin "Maqedonia jote" të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, dhe pothuajse 12% votuan për koalicionin "Për një ardhmëri evropiane" të udhëhequr nga LSDM (Grafiku 13). Çdo i dhjeti i anketuar (10%) votoi për koalicionin "Fronti Evropian" të udhëhequr nga BDI-ja, ndërsa 8% për Koalicionin "Vlen". Një numër i ngjashëm i të anketuarve votuan për Levicën dhe ZNAM: pak më pak se 4%.


Grafiku 13. Për kë keni votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024?



Mbështetja më e madhe për koalicionin "Maqedonia jote" është regjistruar në rajonin e Vardarit (50%) dhe rajonin juglindor (41%), dhe e njëjta gjë është rasti me koalicionin "Për një ardhmëri evropiane" (22% dhe 28% respektivisht) (Grafiku 14). Koalicioni "Maqedonia jote" ka mbështetje të lartë në rajonin e Shkupit (38%) dhe Pellagonisë (37%). Koalicioni i Frontit Evropian ka mbështetjen më të madhe në rajonin e Pollogut (30%) dhe rajonin


Jugperëndimor (30%). "Vlen" ka mbështetjen më të madhe në rajonin e Pollogut (27%) dhe rajonin Verilindor (16%). Koalicionet më të mëdha të partive shqiptare kishin mbështetje në 10-12% të votave në rajonin e Shkupit. Mbështetjen më të madhe Levica e ka në rajonin Verilindor (10%) dhe rajonin e Vardarit (9%), ndërsa ZNAM në rajonin Verilindor (8%) dhe rajonin Juglindor (8%).

Grafiku 14. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajoneve



Koalicionet "Fronti Evropian" dhe "Vlen" kanë mbështetje më të madhe midis banorëve që jetojnë në fshat (18% dhe 12%) krahasuar me qytetet (5% dhe 6%) (Grafiku 15). ZNAM ka më shumë mbështetje midis banorëve që jetojnë në qytet (5%) sesa në fshat (2%). Nuk kishte dallime statistikisht të rëndësishme midis burrave dhe grave.


Grafiku 15. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas vendbanimit



Koalicioni "Maqedonia Jote" ka mbështetjen më të madhe në mesin e grupit më të vjetër të të anketuarve (65+) - 64% (Grafiku 16). Koalicioni "Fronti Evropian" ka më shumë mbështetje midis tre grup moshave më të reja (18-44 vjeç) dhe varion nga 12% deri në 15%,


ndërsa mbështetja për "Vlen" shpërndahe në mënyrë më të barabartë midis grupeve të të anketuarve nga 18 në 64 vjeç (kryesisht rreth 11%), ndër të cilat është më e lartë. ZNAM ka më shumë mbështetje midis të rinjve (18-24 vjeç) dhe grupit më të vjetër të të anketuarve (65+): përkatësisht 7% dhe 5%. Dallimet në mbështetjen e koalicionit "Për një ardhmëri evropiane" sipas moshës së të anketuarve nuk është statistikisht e rëndësishme.

Grafiku 16. Vendimi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës



Sa i përket prejardhjes etnike, ZNAM ka një mbështetje mbizotëruese midis maqedonasve (5%) në krahasim me shqiptarët (më pak se 1%), dhe këto dallime janë statistikisht të rëndësishme edhe në mbështetjen e maqedonasve (18%) dhe komuniteteve të tjera etnike (15%) në krahasim me shqiptarët (3%) për Koalicionin "Për një ardhmëri evropiane" (Grafiku 17). Koalicioni "Maqedonia Jote" nuk ka aspak mbështetje në mesin e popullatës shqiptare, por një përqindje relativisht e lartë prej 38% e të anketuarve nga bashkësitë e tjera etnike votuan për këtë koalicion. Levica ka mbështetje vetëm midis maqedonasve në mostrën tonë (6%). Koalicionet "Vlen" dhe "Fronti Evropian" kanë mbështetje, para se gjithash, nga popullsia shqiptare, përkatësisht 34% dhe 42%, dhe me një mbështetje minimale prej 2% midis pjesëtarve të bashkësive tjera në këtë mostër.

Grafiku 17. Vendimi zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike



## Ndryshimet në votim midis vitit 2020 dhe 2024

Moduli i HKSZ gjithashtu përmban pyetje të dedikuara për votimin e kaluar të qytetarëve. Në mostrën e kryer, 72% e të anketuarve kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, pothuajse e njëjta përqindje si në vitin 2024. Për më tepër, 88% (N=680) e të anketuarve që votuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 kanë votuar gjithashtu edhe në zgjedhjet e vitit 2020. Kjo është një përqindje jashtëzakonisht e lartë që tregon se ekziston një segment më i madh i qytetarëve që është shumë aktiv në formën më të shpeshtë formale të pjesëmarrjes politike – votimit.

Por cilat janë ndryshimet në drejtim të mbështetjes për partitë dhe koalicionet? Rezultatet sugjerojnë një farë stabiliteti në elektorat, përkatësisht ekzistencën e një numri të madh të votuesve të përhershëm të partive dhe koalicioneve, por edhe një përqindje të caktuar të votuesve "flotantë", gjegjësisht votuesve që ndryshojnë zgjedhjen e tyre më shpesh. Në rastin e subjekteve të reja që u shfaqën në këto zgjedhje, siç është Koalicioni "Vlen", shumica e votuesve vijnë nga opsionet nga të cilat janë ndarë këto opsione (Koalicioni i vitit 2020 i Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativa dhe LSDM, përkatësisht).


Paraqitje më të hollësishme të votimit në vitin 2024 përmes prizmit të votës së dhënë në vitin 2020 janë në dispozicion në Grafikon 18. 11% e të anketuarve që votuan për VMRO-DPMNE-në dhe koalicionin në zgjedhjet në vitin 2024, në vitin 2020 votuan për LSDM-në dhe koalicionin. VMRO-DPMNE tërhoqi gjithashtu 2.7% të votuesve të së Majtës, si dhe 0,4% të votuesve të Partisë maqedonase konservatore Integra. LSDM, nga ana tjetër, tërhoqi votuesit e mëparshëm të BDI-së (pothuajse 5% të numrit të përgjithshëm të votave për LSDM-në). Ndërkohë, Fronti Evropian i BDI-së tërhoqi një numër të vogël ish votuesish të Aleancës së Shqiptarëve (5%), Partisë Demokratike të Shqiptarëve (2.5%) dhe koalicionit të LSDM-së (1.2%).

Përveç mbështetjes që në pjesën më të madhe vjen nga qytetarët që votuan për koalicionin midis Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës në zgjedhjet e vitit 2020 (69%), "Vlen" ka tërhequr edhe votuesit e BDI-së (24% brenda votuesve të saj), LSDM-së (5%) dhe Partisë Demokratike të Shqiptarëve (2%).

Levica, ndërkohë, arriti të tërheqë vota si nga koalicioni VMRO-DPMNE (20% e votave për Levicën në 2024) ashtu edhe nga koalicioni i LSDM-së (18%). E sapoformuara ZNAM në

korpusin e saj të votave tërhoqi qytetarë të cilët në zgjedhjet e mëparshme të vitit 2020 votuan për disa parti etnike maqedonase, si dhe nga një parti e shqiptarëve. Kështu, 66% nga votuesit e ZNAM-it, në zgjedhjet e kaluara votuan për LSDM-në dhe koalicionin, ndërsa 12% për koalicionin VMRO-DPMNE. ZNAM ka tërhequr dhe votuesit e Levicës (10%), të partive të krahut të djathtë Integra (5.5%) dhe të Maqedonisë së Bashkuar (3%), si dhe të Aleancës për Shqiptarët (4%).

Grafiku 18. Mbështetja e votuesve në vitin 2024 sipas votimit në vitin 2020, zgjedhjet parlamentare




# Formimi i vendimeve zgjedhore

## Arsyet e zgjedhjes së votës

Të anketuarve iu bënë disa pyetje në lidhje me arsyet pse votuan për një listë të caktuar partish ose një kandidat/e të caktuar, duke marrë parasysh diversitetin e kandidatëve nga perspektiva etnike, gjinore dhe partiake. Sipas deklaratave të të anketuarve (Grafiku 19), kur vendoset se për kë do të votojnë në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, për shumicën e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut gjëja më e rëndësishme është cilësia e kandidatit/ es ("Ai/ajo ishte kandidati më i mirë për mua"), 38%, ndërsa për një numër pak më të vogël, është partia që kandidon kandidatin/en (35%). Perceptimi i pikëpamjeve dhe interesave të përfaqësuara nga kandidati/ja (18%) është gjithashtu disi i rëndësishëm. Në mënyrë kumulative, këto gjetje tregojnë se të anketuarit vlerësojnë me kujdes karakteristikat e kandidatëve të nominuar. Kjo përforcohet gjithashtu nga pikëpamjet se përkatësia etnike (4%) dhe gjinia e kandidatëve (3% për gjininë femërore), të cilat lidhen me identitetin grupor të kandidatëve, janë më pak të rëndësishme sesa karakteristikat e tyre personale. Megjithatë, duhet të theksohet se, sipas të dhënave të tjera nga sondazhi, votimi në bazë të të njëjtës etni ishte sigurisht një realitet në raundin e parë të zgjedhjeve. Së fundi, rajoni nga vjen kandidati/ja, i cili është i rëndësishëm për sjelljen zgjedhore të qytetarëve në disa vende të tjera në zgjedhjet presidenciale në vitin 2024 në Maqedoninë e Veriut, nuk ka rëndësi.

Grafiku 19. Arsyetja e zgjedhjes së një kandidati/e presidencial/e\*




Të anketuarit nga rajoni i Pollogut (51%) dhe rajoni i Shkupit (39%) dhanë votën e tyre në përqindjen më të madhe në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale për shkak të mbështetjes që kandidati mori nga partia përkatëse, ndërsa për banorët e rajonit Verilindor (59%), Lindor (40%), rajoni i Vardarit (49%) dhe rajonit të Pellagonisë (46%) cilësia e kandidatit/es së propozuar është më e rëndësishme. Për banorët e rajonit Jugperëndimor (17%), përkatësia etnike e kandidatit është më e rëndësishme, krahasuar me të gjitha rajonet e tjera.

Për të anketuarit që jetojnë në fshat, partia që propozon kandidatin/en (41% kundrejt 31% të banorëve të qytetit) ose përkatësia etnike (6% kundrejt 2% të banorëve të qytetit) është më e rëndësishme, ndërsa për të anketuarit që jetojnë në qytet, vetë kandidati/ja (41% kundrejt 31% të banorëve të fshatit) është më i/e rëndësishëm/me.

Një përqindje më e lartë e grave (6%) u përgjigjën se votuan për shkak të gjinisë femërore të kandidatës krahasuar me meshkujt (1%). Grupi më i ri i të anketuarve (18-24 vjeç) në përqindjen më të madhe (30%) vendosën t'i japin votën e tyre një kandidati/e të veçantë sepse ai/ajo përfaqëson pikëpamje/interesa të caktuara, por edhe për shkak të etnisë (10%).

Votimi për një kandidat/e për shkak të mbështetjes nga partia që e propozon atë është më e përhapura midis shqiptarëve (45%) midis grupeve etnike, pasuar nga maqedonasit (33%) dhe grupi i përbërë nga të anketuarit që i përkasin komuniteteve të tjera etnike (17%) (Grafiku 20). Për shqiptarët (11%), përkatësia etnike është më e rëndësishme krahasuar me maqedonasit (1%). Komunitetet e tjera etnike votuan më së shumti nga të gjitha grupet demografike sepse kandidatja ishte grua (madje 15%, shumë më tepër se mesatarja e përgjithshme). Për ta (30%), si dhe për maqedonasit (20%), është më e rëndësishme se cilat pikëpamje/interesa përfaqëson kandidati/ja, krahasuar me shqiptarët (5%).


Grafiku 20. Arsyeja e zgjedhjes së një kandidati/e presidencial/e, sipas përkatësisë etnike\*



Çfarë ndikon në vendimin zgjedhor kur bëhet fjalë për zgjedhjet parlamentare? Për pothuajse një të tretën e të anketuarve (32%), është programi i partisë për të cilën kanë votuar (Grafiku 21). Përqindja e qytetarëve për të cilët besimi në udhëheqjen e partive është arsyeja më e rëndësishme për të votuar (28%) është gjithashtu afër kësaj përqindjeje. Besimi në kandidatët e nominuar është arsyeja e radhës, të cilën e ndajnë pothuajse një e pesta e të anketuarve (19%). Mjedisi social i të anketuarve ka më pak ndikim gjatë votimit (11%). Vetëm 4% e të anketuarve deklarojnë se vendosin se për kë do të votojnë për shkak të ndonjë interesi/përfitimi vetjak.




Grafiku 21. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024\*



Programi është më i rëndësishëm për votim për të anketuarit që jetojnë në rajonet e Shkupit (42%), rajonin Verilindor (44%) dhe rajonin Lindor (33%), ndërsa besimi në udhëheqjen e partisë është më i rëndësishëm për banorët e rajonit Jugperëndimor (51%) dhe të Pollogut (39%) (Grafiku 22). Besimi tek kandidatët është më i rëndësishmi për të anketuarit nga rajoni i Pellagonisë (37%). Mjedisi i të anketuarve janë shumë mbi mesataren e përgjithshme midis të anketuarve nga rajoni i Vardarit (19%), Pollogut (19%) dhe rajonit Juglindor (16%). Përfitimi personal nga votimi është më i theksuar në mesin e të anketuarve nga rajoni Lindor (12%) dhe rajoni i Vardarit (9%). Për të anketuarit nga zonat rurale (35%), besimi në udhëheqjen e partisë është më i rëndësishëm krahasuar me të anketuarit nga zonat urbane (25%), ndërsa për gratë (25%), besimi tek kandidatët është më i rëndësishëm krahasuar me burrat (15%).


Grafiku 22. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas rajonit\*



Programi i partive është më i rëndësishmi për grup moshën 35-44 vjeç (33%), si dhe për të anketuarit 55-64 dhe 65+ vjeç (përkatësisht 33% dhe 36%), ndërsa për madje 40% të të anketuarve më të rinj (18-24 vjeç), më i rëndësishmi është besimi në udhëheqjen e partive. Të anketuarit nga tre grup moshat e para 18-44 vjeç gjithashtu më shpesh theksojnë fitimin personal nga votimi dhe ai rritet me moshën brenda këtyre tre grupeve (6%-9%). Besimi tek kandidatët është më karakteristik për të anketuarit nga grup moshë 55-64 vjeç (24%).

Shikuar nga përkatësia etnike, votimi për programin e partisë është më karakteristik për maqedonasit (34%) dhe shqiptarët (32%), krahasuar me anëtarët e komuniteteve më të vogla etnike (15%) (Grafiku 23). Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve shqiptarë (35%) zgjedhën besimin në udhëheqjen e partisë, krahasuar me 26% të maqedonasve dhe komuniteteve më të vogla etnike (26%). Besimi në kandidatët e partive është më i rëndësishëm për maqedonasit (21%), krahasuar me shqiptarët (13%) dhe komunitetet e tjera etnike (16%). Për komunitetet më të vogla etnike, arsyet tepër të rëndësishme për të votuar janë mjedisi në të cilin jetojnë (19%) dhe përfitimet personale (16%).


Grafiku 23. Arsyet për vendim zgjedhor në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike\*



## Koha e vendimit zgjedhor


Shumica (59%) e qytetarëve që votuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, edhe para se të fillonte fushata zgjedhore, e dinin se për kë do të votonin (Grafiku 24). Për një të tretën e të anketuarve, vendimi zgjedhor u mor gjatë fushatës dhe gati 7% e të anketuarve vendosën se për kë do të votonin në ditën e votimit. Kjo do të thotë që partitë politike kanë mundësinë të ndikojnë në sjelljen zgjedhore të një 40% të lartë të votuesve gjatë fushatës zgjedhore.

Grafiku 24. Koha e vendimit zgjedhor\*



Potenciali për ndikim gjatë fushatës zgjedhore është më i madh në mesin e të anketuarve nga rajoni i Pellagonisë (53%), Verilindor (42%), i Vardarit (36%) dhe rajoni i Shkupit (31%) të cilët marrin vendimin zgjedhor gjatë fushatës (Grafiku 25). Deri në 15% e të anketuarve nga rajoni i Pollogut marrin vendimin në ditën e votimit, si dhe 9% e të anketuarve nga rajoni Jugperëndimor dhe Verilindor, dhe 6% e të anketuarve nga rajoni i Pellagonisë. Në tërësi, potenciali për ndikim është më i madh në rajonin Verilindor dhe të Pellagonisë.

Grafiku 25. Koha e vendimit zgjedhor, sipas rajonit\*




Dallime të tjera ndodhin vetëm në lidhje me moshën e të anketuarve dhe në lidhje me vendimmarrjen në ditën e votimit. Kjo ndodh më shpesh me të rinjtë 18-24 vjeç (15%), si dhe me të anketuarit e moshës 55-64 vjeç (9%).

## Shkaqet e abstenimit

Arsyet e abstenimit nga zgjedhjet parlamentare në 2024 lidhen kryesisht me mungesën e interesit për politikën (36%), por edhe zhgënjimin nga partitë (30%) (Grafiku 26). Për rreth 8% të të anketuarve, arsyet janë informimi i pamjaftueshëm ose pamundësia për të identifikuar një parti të afërt me pikëpamjet e tyre. Saktësisht 13% e të anketuarve u përgjigjën se abstenuan sepse u penguan të votojnë.


Grafiku 26. Arsyet e abstenimit nga votimi\*



Të anketuarit që abstenuan nga zgjedhjet (N=174) nga rajoni Lindor (56%) dhe rajoni i Pellagonisë (55%) theksuan mungesën e interesit për politikën, ndërsa të anketuarit nga rajoni i Vardarit ishin më së shumti të zhgënjyer me partitë (deri në 75%). Dështimi për të


pasur një parti të afërt me pikëpamjet e të anketuarit është arsyeja më e rëndësishme për abstenim për banorët e rajonit Verilindor (21%). E njëjta gjë ndodh me të anketuarit që jetojnë në fshat (15%) krahasuar me të anketuarit nga qytetet (vetëm 3%). 16% e të anketuarve nga grup mosha më e re (18-24 vjeç) ndajnë të njëjtën pikëpamje, ndërsa të anketuarit nga tre kategoritë e moshës 25-54 vjeç janë më të zhgënjyer me partitë (42%-51%) krahasuar me më të rinjtë (10%) (Grafiku 27). 45% e të anketuarve deri në 35 vjeç dhe 47% nga 55-64 vjeç theksojnë (mos) interesin në politikë si arsye për abstenim.

Grafiku 27. Vendimet për abstenim në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas moshës\*



Mosinteresimi për politikën si arsye për abstenim është më i përhapur midis anëtarëve të komuniteteve të tjera etnike (53%), ndërsa informacioni i pamjaftueshëm është shumë më shpesh arsye për abstenim midis shqiptarëve (24%) (Grafiku 28). Përqindja më e madhe e shqiptarëve gjithashtu theksoi se mos afërsia me pikëpamjet e partive është një arsye për abstenim (18%). Mund të konkludohet se qytetarët me etni shqiptare janë më pak të informuar për ofertën politike ose mendojnë se partitë politike nuk janë afër pikëpamjeve të tyre.


Grafiku 28. Vendimet për abstenim në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, sipas përkatësisë etnike\*



## Perceptimet për vendimin zgjedhor personal

Qytetarët në përgjithësi janë të kënaqur me zgjedhjen e tyre personale gjatë votimit në prill dhe maj 2024 (Grafiku 29). Një shumicë e madhe e atyre që votuan raportuan se ishin të kënaqur me vendimin e tyre nga votimi: 33% "shumë" dhe 50% "deri diku". Ata që abstenuan nga votimi janë të kënaqur në një masë më të vogël, por ende në numër të konsiderueshëm: 26% "shumë" dhe 22% "deri diku". Çdo i dhjeti abstenues nuk mund të vlerësonte kënaqësinë e tij, përkatësisht, është përgjigjur me "nuk e di" në pyetjen.


Grafiku 29. Kënaqësia me vendimin zgjedhor




## Perceptimet për ofertën zgjedhore

Një shumicë e qytetarëve janë të kënaqur me diversitetin e ofertës zgjedhore (Grafiku 30): 42% janë të kënaqur "pjesërisht", dhe një pjesë plotësisht prej 14% janë të kënaqur "shumë". Pak më shumë se një e treta janë të pakënaqur dhe vetëm 10% janë "aspak të pakënaqur". Qytetarët në rajonin Jugperëndimor ndryshojnë nga pjesa tjetër e rajoneve për sa i përket kënaqësisë së tyre - deri në 39% raportuan se ishin "shumë të kënaqur", krahasuar me 2%-16% në pjesën tjetër të rajoneve (Grafiku 31).

Grafiku 30. Kënaqësia me ofertën zgjedhore




Grafiku 31. Kënaqësia me ofertën zgjedhore, sipas rajonit



## Frekuenca e votimit për të njëjtin opsjon politik


Shumica e të anketuarve raportuan se kryesisht votojnë për të njëjtin opsjon politik: 37% se në të gjitha zgjedhjet votojnë për të njëjtën parti, ndërsa gati 30% se në shumicën e zgjedhjeve votojnë për të njëjtën parti (Grafiku 32). Rreth një e katërta e të anketuarve votojnë për parti të ndryshme, ndërsa vetëm një përqind nuk votojnë kurrë.

Grafiku 32. A votoni për të njëjtën parti në të gjitha zgjedhjet?\*



Votuesit më të qëndrueshëm, të cilët gjithmonë votojnë për të njëjtën parti, janë në përqindjen më të madhe nga Shkupi (47%) dhe rajoni i Pollogut (42%), pasuar nga të anketuarit nga rajoni Juglindor (38%) dhe rajoni i Pellagonisë (35%) (Grafiku 33). Gati gjysma (43%) e të anketuarve të rajonit të Vardarit në shumicën e zgjedhjeve votojnë për të njëjtën parti. Qytetarët nga rajoni Lindor (36%), Verilindor (36%) dhe i Vardarit (30%) kryesisht votojnë për parti të ndryshme. Të anketuarit nga qytetet në krahasim me të anketuarit nga fshatrat votojnë më shpesh për parti të ndryshme: 28% kundrejt 20%.

Grafiku 33. Votimi për të njëjtën parti, sipas rajonit\*




Maqedonasit në përqindjen më të madhe gjithmonë votojnë për të njëjtën parti (41%), ndërsa shqiptarët (39%) në përqindje më të madhe votojnë në shumicën e zgjedhjeve për të



njëjtën parti (Grafiku 34). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera etnike më shpesh votojnë për parti të ndryshme (46%), dhe kjo përqindje është gjithashtu më e lartë në mesin e maqedonasve (25%), krahasuar me shqiptarët (18%).

Grafiku 34. Votimi për të njëjtën parti, sipas përkatësisë etnike\*




# Fushata zgjedhore

## Pjesëmarrja qytetare në fushatën zgjedhore

Qytetarët morën pjesëmarrje të konsiderueshme në aktivitetet mobilizuese të partive politike gjatë fushatës zgjedhore (Grafiku 35): një e katërta kanë marrë pjesë në një tubim, ose një ngjarje më të vogël fushate, si për shembull takim me qytetarët; një e treta u vizituan në shtëpitë e tyre nga aktivistë të cilët u prezantuan atyre programin zgjedhor; dhe pothuajse gjysma kanë marrë materiale reklamuese nga partitë politike. Përveç kësaj, çdo i tetë i anketuar ka theksuar një shenjë të partisë/fushatës në vetvete ose në ndërtesën ku ai/ajo jeton, dhe çdo i dhjeti ishte i përfshirë drejtpërdrejt, përkatësisht ka punuar në një fushatë zgjedhore të një partie ose kandidati.

Grafiku 35. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese të partive gjatë fushatës\*




Megjithatë, ka dallime të rëndësishme gjinore, të moshës dhe etnike për sa i përket pjesëmarrjes në fushatë. Në të gjitha këto aktivitete, meshkujt kishin më shumë gjasa të merrnin pjesë sesa femrat (Grafiku 36). Në mënyrë të ngjashme, anëtarët e grup moshës më të re përfshihen në mënyrë të konsiderueshme më të ulët se grupet e tjera dhe shumë nën mesataren në të gjitha aktivitetet e ofruara, dhe e njëjta gjë vlen edhe për grup moshën më të vjetër për sa i përket të gjitha aktiviteteve përveç shpërndarjes së materialit reklamues dhe vizitave me qëllim paraqitjen e programit.

Së fundi, maqedonasit më shpesh sesa shqiptarët u vizituan nga aktivistët që kanë prezantuar programin, si dhe më shpesh kanë pranuar materiale reklamuese, ndërsa, përkundrazi, shqiptarët më shpesh sesa maqedonasit kanë punuar në një fushatë zgjedhore (Grafiku 37).


Aktivitetet për mobilizim të organizuara nga partitë dhe selitë e fushatave, rrjedhimisht, më shpesh përfshijnë burra dhe grup moshë të mesme, ndërsa ka dinamikë të ndryshme për

sa i përket grupeve etnike, veçanërisht për sa i përket mobilizimit derë më derë dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aktivitetet e fushatës.

*Grafiku 36. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese, sipas gjinisë\**




*Grafiku 37. Përqindja e të anketuarve që kanë marrë pjesë në aktivitetet mobilizuese, sipas përkatësisë etnike\**



## Burimet e informimit gjatë fushatës


Qytetarët përdorën burime të ndryshme informimi gjatë fushatës zgjedhore (Grafiku 38). Burimet më të përdorura janë kanalet televizive (stacionet televizive private dhe shërbimi publik), pasuar nga mediat sociale (të tilla si Facebook, X/Twitter, Instagram dhe TikTok) dhe portalet e internetit të specializuara në lajme. Radioja dhe media e shkruar përdoren relativisht shumë më rrallë.

Grafiku 38. Mediat e përdorura gjatë fushatës me qëllim ndjekjen e lajmeve, në baza javore




Kjo fotografi e përgjithshme nuk ndahet nga të gjitha grup moshat. Ndërsa grup moshë më e vjetër (65+) shikon televizion në shumicë dërrmuese në baza ditore, pothuajse gjysma e grupit më të ri (18-25) nuk shikon fare lajme në televizion privat ose në shërbimin publik (Grafikët 39 dhe 40). Nga ana tjetër, grupi më i vjetër në shumicë nuk kanë përdorur ueb portalet për të monitoruar lajmet dhe rrjetet sociale gjatë fushatës. Grupi më i ri, nga ana tjetër, ndryshon për sa i përket mosinformimit nga pjesa tjetër: grupe të konsiderueshme të të anketuarve të moshës 18-25 vjeç thanë se ata "asnjëherë" nuk kanë ndjekur lajmet në burimet e ofruara gjatë fushatës.

Grafiku 39. Përqindja e të anketuarve që kanë ndjekur lajmet çdo ditë gjatë gjithë fushatës, sipas grup moshës dhe mediave




Grafiku 40. Përqindja e të anketuarve që nuk kanë ndjekur kurrë lajme gjatë fushatës, sipas grup moshës dhe medias



## Klientelizmi zgjedhor

Më pak se 4% e të anketuarve raportuan se në prag të zgjedhjeve kanë pranuar ofertë nga një parti ose kandidat për të shitur votën e tyre (Grafiku 41). Shkalla është më e lartë në grupin e përbërë nga etni të ndryshme përveç etnisë maqedonase dhe shqiptare (9% krahasuar me 3% midis maqedonasve dhe shqiptarëve). Shkalla është gjithashtu më e lartë në grup moshat 25-34 (7%) dhe 35-44 (9%) krahasuar me të tjerët (0%-2%). Ofertat kryesisht përbëheshin nga premtime për punësim (pothuajse një e treta e atyre që morën ofertë) dhe premtime për shërbime në kryerjen e punës me institucione (pothuajse 19%), dhe më rrallë përbëheshin nga para (11%) dhe lloje të tjera të dhuratave materiale me më pak vlerë siç janë produktet ushqimore, veshmbathjet, pajisjet shtëpiake, etj. (10%). Vetëm 1.6% raportuan se kanë pranuar kërcënim në lidhje me mënyrën e votimit në prag të zgjedhjeve.

Grafiku 41. Përvojë me klientelizmin zgjedhor\*



# Lidhje midis partive dhe qytetarëve


## Afërsia me partitë

Gati një e treta e qytetarëve ndihen shumë afër një partie të caktuar politike, ndërsa një pjesë plotësuese prej 10% janë pak më afër një partie të veçantë politike në krahasim me një tjetër (Grafiku 42). Nga ky numër i të anketuarve që raportuan se ndjejnë afërsi, shumica ndjejnë identifikim partiak me VMRO-DPMNE-në (40%), pasuar nga LSDM-ja (19%), BDI-ja (13%), E Majta (Levica) (7%), Aleanca për Shqiptarët e Taravarit (4%) dhe ZNAM (4%) (Grafiku 43).

Grafiku 42. Perceptimi për afërsinë personale me një parti të caktuar politike




Grafiku 43. Cilën parti e ndieni më të afërt?



Nga ata që kanë zgjedhur ndonjë nga partitë e listuara, pak më pak se një e treta (30%) e karakterizojnë afërsinë e tyre me partinë e përzgjedhur si "shumë të afërt" ndërsa një shumicë (60%) e karakterizojnë si "disi të afërt" (Grafiku 44). Burrat dukshëm më shpesh sesa gratë raportuan afërsi të madhe me partinë e zgjedhur (37% kundrejt 19%), si dhe maqedonasit krahasuar me shqiptarët (32% kundrejt 26%).


Grafiku 44. Shkalla e afërsisë me partinë e përzgjedhur




## Anëtarësia në parti politike

Çdo qytetar/e i/e shtatë (13%) është zyrtarisht anëtar/e i/e një partie politike. Shkalla e anëtarësimit, megjithatë, ndryshon sipas rajonit, gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike. Sipas rajonit, shkalla e anëtarësimit është më e larta në Shkup (17%), Pollog (16%) dhe rajonin Juglindor (15%), dhe më e ulëta në Lindje (6%) (Grafiku 45). Burrat janë më shpesh anëtarë sesa gratë (17% kundrejt 8%), dhe e njëjta gjë vlen për grup moshat e mesme, 25-34 (16%), 35-44 (19%) dhe 45-54 (21%) krahasuar me grupin më të ri 18-24 (7%) dhe më të moshuarit 55-64 (8%) dhe 65+ (7%) (Grafiku 46). Maqedonasit dhe shqiptarët (përkatësisht 14% dhe 16%) janë më shpesh anëtarë të partive në krahasim me grupin e përbërë nga anëtarë të etnive të tjera (4%).

Grafiku 45. Anëtarësia në parti sipas rajonit\*




Grafiku 46. Anëtarësia në parti sipas grup moshës\*





Anëtarësimi në parti kërkon një nivel të konsiderueshëm të aktivitetit nga anëtarët (Grafiku 47): gati gjysma e atyre që deklaruan se janë anëtarë (47%) raportuan se marrin pjesë në aktivitete partiake të paktën një herë në muaj ose më shpesh, ndërsa një e treta (33%) raportuan se aktivitete të tilla ndodhin disa herë në vit. Vetëm çdo i dhjeti anëtar (11%) ka aktivitete partiak një herë në vit, ndërsa një pakicë e vogël prej nën 5% - asnjëherë. Prandaj, shumica e anëtarëve të partive politike kanë angazhime të rëndësishme partiake gjatë një viti, një gjetje që tregon socializim të rëndësishëm të qytetarëve përmes infrastrukturave partiake.

Grafiku 47. Frekuenca e pjesëmarrjes në aktivitetet e partisë\*




## Afekte ndaj partive politike dhe liderëve


Megjithëse qytetarët në numër të madh raportojnë afërsinë me organizatat partiake dhe anëtarësinë relativisht të lartë të partive, afekti negativ ndaj partive politike/koalicioneve mbizotëron në vend (Grafiku 48) dhe udhëheqësit kryesorë politikë (Grafiku 49). Më shumë se një e katërta e popullsisë shpreh mospëlqim të përgjithshëm për VMRO-DPMNE-në, dhe udhëheqësin e saj Hristijan Mickoski, ndërsa pakica të vogla raportojnë një afekt të plotë pozitiv. Në përgjithësi, kjo performancë është ende më e mira nga të gjitha partitë dhe liderët e ofruar. Në mesin e partive, përqindja e mospëlqimit të përgjithshëm varion nga pothuajse 34% në ZNAM deri në 61% te BDI, ndërsa në mesin e liderëve të partive nga 29.5% për Maksim Dimitrievskin në pothuajse 62% në rastin e Ali Ahmetit. Ndër dy kandidatët më të njohur presidencialë - Gordana Siljanovska Davkova qëndron më mirë se Stevo Pendarovski: 8% raportuan se Siljanovska-Davkova "më pëlqen shumë" krahasuar me 3% për Pendarovskin; si dhe 24% të cilët thanë se Siljanovska-Davkova "nuk i pëlqen aspak" krahasuar me 34% për Pendarovskin. Qytetarët që shikojnë plotësisht pozitivisht në ndonjë nga subjektet politike ose udhëheqësit llogariten në përqindje një shifrore.

Shkalla e pëlqimit për partitë dhe udhëheqësit përcaktohet kryesisht nga përkatësia etnike e qytetarëve. Shqiptarët e shohin VMRO-DPMNE-në dukshëm më negativisht (42% raportuan se "nuk u pëlqen aspak") krahasuar me maqedonasit (22%). Maqedonasit, nga ana tjetër, e shohin shumë më pozitivisht krahasuar me shqiptarët - 13% e maqedonasve "u pëlqen shumë VMRO-DPMNE" krahasuar me 1% të shqiptarëve. Në LSDM, pamja është pjesërisht e kundërt: 43% e maqedonasve nuk e pëlqejnë aspak këtë parti në krahasim me 25% të shqiptarëve që kanë të njëjtën pikëpamje për LSDM-në. Nga ana tjetër, ZNAM dhe Levica perceptohet më shumë negativisht nga shqiptarët sesa nga maqedonasit, ndërsa BDI dhe Koalicionit "Vlen" kanë një imazh më negativ midis maqedonasve sesa midis shqiptarëve. Pamja për sa i përket liderëve politikë që vijnë nga të njëjtat subjekte politike është pothuajse identike për sa i përket kësaj ndarjeje etnike.

Grafiku 48. Afekte ndaj partive politike dhe koalicioneve



Grafiku 49. Afekte ndaj liderëve politikë dhe një pjesë të kandidatëve presidencialë




## Perceptimet për vlerat që përfaqësojnë partitë

Të anketuarit u pyetën të përcaktojnë deri në tre vlera që janë më të rëndësishme për partinë për të cilën votuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024. Tre vlerat më të zakonshme të zgjedhura janë drejtësia, orientimi evropian dhe puna e ndershme. Pothuajse një e treta e

qytetarëve zgjedhën njëri nga këto vlera si zgjedhjen e tyre të parë, të dytë ose të tretë të vlerës nga lista e ofruar prej pesëmbëdhjetë vlerash (Grafiku 50).

Grafiku 50. Vlerat më të rëndësishme për partinë për të cilën kanë votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024\*



Në hapin tjetër, përcaktojmë nëse ka dallime midis mbështetësve të partisë në lidhje me perceptimin e tyre për vlerat që përfaqësojnë të njëjtat parti (Tabela 2). Kështu, për mbështetësit e koalicionit VMRO-DPMNE, vlerat më të rëndësishme karakteristike të kësaj partie janë: dashuria për atdheun, puna e ndershme dhe drejtësia. Puna e drejtë dhe drejtësia janë vlera që votuesit ia atribuojnë Levicës, "Vlen" dhe ZNAM, për të cilët gjithashtu të rëndësishme janë: janë me orientim evropian për "Vlen", orientimi drejt vendeve të tjera si Rusia dhe Kina për votuesit e Levicës dhe individualizmi/liria individuale për votuesit e ZNAM. Orientimi evropian është vlera më të cilën votuesit e BDI-së e perceptojnë këtë parti, për të cilën drejtësia dhe dashuria për grupin etnik që përfaqëson partia është gjithashtu e rëndësishme. LSDM-ja perceptohet ndryshe nga votuesit e saj dhe ndan më pak vlera me votuesit e partive të tjera, pasi vlerat e sigurisë sociale dhe individualizmit/lirisë individuale nuk renditen në tre më të rëndësishmet për votuesit e partive/koalicioneve të tjera. Përjashtim bën individualizmi, i cili është më i larti në mesin e votuesve të ZNAM.


Tabela 2. Vlerat më të rëndësishme të partive/koalicioneve (qëndrimet e votuesve)\*

LSDM dhe koalicioni	VMRO-DPMNE dhe koalicioni	Fronti evropian - BDI	Koalicioni "Vlen"	E Majta	ZNAM
Orientimi evropian (68.5%)	Dashuria për atdheun (57.7%)	Orientimi evropian (79.9%)	Orientimi evropian (51.1%)	Drejhtësia (43,2%)	Drejhtësia (49%)
Mbrojtja sociale (40.1%)	Punë e ndershme (45.2%)	Drejhtësia (30.4%)	Drejhtësia (48.2%)	Punë e ndershme (40.3%)	Individualizmi/liria e individit (46.2%)
Individualizmi/liria e individit (32.9%)	Drejhtësia (38,1%)	Dashuria për grupin etnik që përfaqëson (27.9%)	Punë e ndershme (43,5%)	Orientimi drejt vendeve të tjera (Rusi, Kinë) (33,5%)	Punë e ndershme (42,9%)

## Perceptimet për profilin ideologjik të partive


Duke përdorur shkallën standarde majtas-djathtas, ku 0 do të thotë "majtas" ndërsa 10 do të thotë "djathtas", të anketuarve iu kërkua të poziciononin partitë në boshtin ideologjik (Grafiku 51). Disa nga të anketuarit nuk dinin si të poziciononin një pjesë të konsiderueshme të partive, ku kjo përqindje ishte më e lartë në rastin e partive politike shqiptare dhe subjekteve të reja politike. Kështu, aktualisht, të anketuarit kanë vështirësinë më të madhe ideologjike për të pozicionuar koalicionin e ri të partive shqiptare - "Vlen": 26% e të anketuarve dhanë një përgjigje të tillë. Pas "Vlen", më e vështira për t'u pozicionuar është BDI (22%), e cila, edhe pse është një parti politike e etabluar, duket se nuk dallohet me një profil të qëndrueshëm ideologjik në sytë e votuesve. Subjekti i ri në skenën politike ZNAM është ideologjikisht i panjohshëm për 19% të të anketuarve. Nga partitë e tjera, Levica nuk mund të pozicionohej nga 15% e të anketuarve, ndërsa përqindja e të anketuarve në LSDM dhe VMRO-DPMNE është e njëjtë (14%).

Grafiku 51. Përqindja e të anketuarve që nuk dinë të pozicionojnë ideologjikisht partinë



Nga të anketuarit që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, morëm një profil ideologjik të partive sipas perceptimeve të të anketuarve (Grafiku 52). Kështu, të anketuarit pozicionojnë më djathtas në boshtin ideologjik VMRO-DPMNE-në (M=6.17; N=757), ndërsa në të majtë është E Majta (M=2.42; N=772). LSDM-ja gjithashtu përputhet dukshëm në pjesën e majtë (M=2.94; N=778), në të cilën BDI anon mesatarisht (M=4.17; N=679). ZNAM graviton rreth qendrës me një prirje të lehtë në të majtë (M=4.57; N=715), ndërsa "Vlen" është pothuajse ideale në qendër (M=4.95; N=633).

Grafiku 52. Perceptimi ideologjik i partive




# (Mos) kënaqësia me demokracinë dhe institucionet

## Perceptimet për zbatimin e demokracisë

Siç theksohet në sondazhe të tjera të ngjashme, qytetarët në Maqedoninë e Veriut janë kritikë ndaj funksionimit të sistemit politik, në përgjithësi vlerësojnë dobët zhvillimin demokratik të vendit dhe shprehin besim të ulët tek institucionet.


Qytetarët janë të ndarë në lidhje me pyetjen se sa demokratike është Maqedonia e Veriut (Grafiku 53). Në shkallën nga 0 ("aspak demokratike") në 10 ("plotësisht demokratike"), shumica e të anketuarve (19%) u përgjigjën me rezultatin mesatar në shkallën - 5. Pothuajse gjysma (49%) u përgjigjën me ndonjë nga notat nga 6 në 10, dhe pothuajse një e treta (31%) me ndonjë nga notat 0-4. Për përqindje shumë të vogla (rreth 3%) Maqedonia e Veriut nuk është aspak ose plotësisht demokratike (normat ekstreme të shkallës). E shprehur si vlerë mesatare, qytetarët besojnë se Maqedonia e Veriut është demokratike në një nivel prej 5.8 në shkallën 0-10.

Grafiku 53. Sa demokratike është Maqedonia e Veriut?



Për më tepër, shumica e qytetarëve shprehin pakënaqësi me procesin demokratik - 41% nuk janë shumë të kënaqur, ndërsa 19% shtesë nuk janë aspak të kënaqur (Grafiku 54). Një numër më i vogël, por ende i rëndësishëm shprehin njëfarë kënaqësie - mbi një e treta janë "deri diku të kënaqur" (36%) ndërsa 3% janë "shumë të kënaqur".

Grafiku 54. Kënaqësia me procesin demokratik




## Perceptimet për efikasitetin e rendit demokratik


Pakënaqësia me funksionimin e sistemit reflektohet edhe përmes pikave të tjera të anketës.

Një shumicë e madhe e qytetarëve besojnë se sistemi nuk ofron kujdes shëndetësor adekuat për të gjithë qytetarët (Grafiku 55): 43% besojnë se sistemi e bën atë "jo shumë mirë", dhe një shtesë prej 36% besojnë se ofrimi i kujdesit shëndetësor "aspak" nuk zbatohet "mirë". Vlerësimi negativ i sistemit shëndetësor është më i lartë në rajonin lindor (63%) (Grafiku 56), më i lartë midis atyre që jetojnë në qytet sesa ata që jetojnë në fshat (38% kundrejt 31%), dhe dramatikisht më i lartë midis maqedonasve (42%) sesa midis shqiptarëve (15%) (Grafiku 57).


Grafiku 55. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor?



Grafiku 56. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor? (sipas rajonit)




Grafiku 57. Sa mirë e garanton sistemi politik kujdesin shëndetësor? (sipas përkatësisë etnike)




Shumica e qytetarëve gjithashtu besojnë se grupe të ndryshme në përgjithësi trajtohen padrejtësisht në vend (Grafiku 58): pothuajse 40% besojnë se trajtimi "nuk është shumë i drejtë", dhe një shtesë prej 16% besojnë se është "shumë i padrejtë". Një e treta perceptojnë njëfarë drejtësie dhe vetëm më pak se 6% drejtësi të madhe. Qytetarët e rajonit të Shkupit dallohen në mendimin se trajtimi është "shumë i drejtë" - 12% kundrejt 0%-7% në rajone të tjera, si dhe maqedonasit në raport me shqiptarët (9% kundrejt 1%). Nga ana tjetër, qytetarët në rajonin Jugperëndimor (36%) dhe Juglindor (28%) në një masë më të madhe se pjesa tjetër e rajoneve perceptojnë një padrejtësi të madhe, veçanërisht në krahasim me rajonin Lindor (3%), Verilindor (9%) dhe rajonin e Vardarit (9%). Shqiptarët (19%) dhe grupi i përbërë nga etni të tjera (29%) në një frekuencë më të lartë se maqedonasit (13%) perceptojnë padrejtësi të madhe (Grafiku 59).



Grafiku 58. Sa trajtohen në mënyrë të barabartë grupet e ndryshme shoqërore?




Grafiku 59. Sa trajtohen në mënyrë të barabartë grupet e ndryshme shoqërore? (sipas përkatësisë etnike)



## Besimi në institucione dhe aktorët kryesorë socialë

Së fundi, pakënaqësia me funksionimin e sistemit reflektohet edhe në besimin e ulët tek institucionet dhe aktorët e rëndësishëm socialë (Grafiku 60), i cili është gjetur në mënyrë të përsëritur nga anketa të tjera të ngjashme. Mosbesimi është më i lartë ndaj gjyqësorit (85%) dhe partive politike (76%), pasuar nga Kuvendi (65%), Qeveria (63%), mediat sociale (63%) dhe mediat tradicionale (62%). Të vetmet grupe të anketuara në të cilat qytetarët kanë më shumë besim sesa mosbesim janë shkencëtarët: shumica e qytetarëve shprehën besim në këtë grup.

Grafiku 60. Besimi në institucionet dhe aktorët kryesorë socialë




Burrat më shumë se gratë në përgjithësi nuk kanë besim te Kuvendi (30% kundrejt 23%) dhe gjyqësori (63% kundrejt 54%), por kanë besim më të lartë te Qeveria (8% kundrejt 5%). Maqedonasit më shumë se shqiptarët dhe "të tjerët" kanë besim të lartë në Qeveri (përkatësisht 9% kundrejt 2% dhe 1%), ndërsa "të tjerët" kanë një shkallë dukshëm më të lartë të mosbesimit të plotë ndaj Qeverisë (53% kundrejt maqedonasve (28%) dhe shqiptarëve (27%). Ndërkohë, maqedonasit kanë një mosbesim të madh dukshëm më të lartë ndaj gjyqësorit (63%) krahasuar me shqiptarët (44%), si dhe një mosbesim të madh dukshëm më të lartë ndaj partive politike (41% kundrejt 32%).

## Perceptimet për procesin zgjedhor


Qytetarët, megjithatë, e shohin procesin zgjedhor më pozitivisht sesa është rasti me institucionet e sistemit dhe aktorët kryesorë. Në shkallën nga 1 deri në 5 ku 1 do të thotë "Zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë të drejtë" dhe 5 do të thotë "Zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë të padrejtë", shumica u përgjigj me notat "1" dhe "2", më shumë se një e katërta me notën "3", dhe 12.5% me notat "4" dhe "5" (Grafiku 61).

Grafiku 61. Perceptimet për drejtësinë e zgjedhjeve



Në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "Për kë votojnë njerëzit nuk do të bëjë ndryshim" dhe 5 do të thotë "Për kë votojnë njerëzit mund të bëjë një ndryshim të madh", gati gjysma u përgjigjën me notat "4" dhe "5", dhe pothuajse një e katërta me notën "3" (Grafiku 62). Nga ana tjetër, pothuajse një e katërta u përgjigjën me notat "1" dhe "2". Maqedonasit në një masë më të madhe (34%) besojnë se votimi mund të bëjë një ndryshim të madh, krahasuar me shqiptarët (25%) dhe grupin e përbërë nga etni të tjera (17%).

Grafiku 62. Perceptimet për efikasitetin e zgjedhjeve




## (Mos)kënaqësia me performancën e qeverisë (2020-2024) dhe çështjet aktuale në vigjilje të zgjedhjeve

Për shumicën e qytetarëve, puna e përbërjes qeveritare që ishte aktuale para zhvillimit të zgjedhjeve (2020-2024) ishte e keqe, ku për 34% ishte "shumë e keqe" dhe për 36% "e keqe" (vetëm një e katërta e të anketuarve thanë se puna ishte "e mirë") (Grafiku 63). Ata nga rajoni Jugperëndimor e vlerësuan punën e qeverisë së mëparshme si "shumë të mirë" (14%), dhe e njëjta gjë vlen për banorët që jetojnë në fshat (7%) krahasuar me banorët që jetojnë në qytet (3%), si dhe midis shqiptarëve (9%) krahasuar me maqedonasit (3%) dhe të tjerët (1%). Nga ana tjetër, maqedonasit (39%) dhe të tjerët (32%) më shpesh sesa shqiptarët (23%) e vlerësuan punën e qeverisë si "shumë të keqe". Kjo e fundit vlen edhe për grup moshën 65+ (43%), si dhe për burrat (37%) krahasuar me gratë (30%). Rezultate të ngjashme u morën për


sa i përket vlerësimeve të punës së qeverisë në trajtimin e pasojave të pandemisë COVID-19, me dallime të ngjashme që rrjedhin nga rajoni dhe vendbanimi, moshë dhe etnia.

Grafiku 63. Perceptimet e punës së Qeverisë (2020-2024)




Të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë performancën e secilit prej subjekteve politike që ishin pjesë e Qeverisë gjatë viteve 2020-2024 (Grafiku 64). Për shumicën, puna e BDI-së (64%), BESA (63%), Aleanca për Shqiptarët (64%), Alternativa (61%) dhe PLD-së (57%) u vlerësua si "e pakënaqshme" në cilësinë e tyre si subjekte që formojnë Qeverinë. Vetëm për bartësin kryesor të koalicionit qeveritar – LSDM – kjo pakënaqësi është dukshëm më e ulët - 44% e vlerësuan punën e ish-partisë në pushtet si "të pakënaqshme". Pakënaqësia me subjektet qeveritare është, si rregull, dukshëm më e lartë në mesin e maqedonasve në krahasim me shqiptarët, si dhe në grup moshën 65+ në krahasim me të tjerët (kjo dinamikë vlen për të gjitha partitë e anketuara). Për shembull, një shumicë e maqedonasve janë plotësisht të pakënaqur me punën e LSDM-së (52%) në Qeveri, krahasuar me një pakicë të shqiptarëve (24%), si dhe një shumicë të grup moshës 65+ (54%) krahasuar me pakicat nga grupet e tjera (40%-43%). Në BDI, këto dallime janë gjithashtu më dramatike: 82% e maqedonasve kundrejt 21% të shqiptarëve janë plotësisht të pakënaqur, si dhe 78% e grupit 65+ në krahasim me 53%-68% të pjesës tjetër të grup moshave.

Grafiku 64. Perceptimet për performancën e partnerëve të koalicionit qeveritar 2020-2024\*




Perceptimet për gjendjen e ekonomisë janë përgjithësisht negative (Grafiku 65). Për pothuajse gjysmën e qytetarëve, situata me ekonominë është përkeqësuar në vitin e fundit (për 29% “disi” dhe për 15% “shumë”), ndërsa për një numër pak më të vogël (41%) ajo mbetet e njëjtë. Për vetëm një pakicë të vogël prej 14% situata ekonomike është përmirësuar. Perceptimet e gjendjes së përkeqësuar “shumë” janë më të lartat në rajonet e Shkupit (25%) dhe të Pollogut (26%) (Grafiku 66), si dhe në mesin e grup moshës 18-24 vjeç (23%).

Grafiku 65. Perceptimet e situatës ekonomike në 12 muajt e fundit




Grafiku 66. Perceptimet e situatës ekonomike në 12 muajt e fundit, sipas rajonit



Qytetarët gjithashtu perceptojnë kryesisht efekte të forta negative të pandemisë COVID-19 (Grafiku 67): për shumicën, pandemia ndikoi negativisht në kohezionin social (66%) dhe funksionimin e demokracisë (64%), si dhe në situatën personale ekonomike (75%). Efektet negative të pandemisë në kohezionin social dhe demokracinë perceptohen më së shumti nga qytetarët që jetojnë në rajonin e Shkupit, rajonin Juglindor dhe të Pellagonisë, si dhe në mesin e grup moshës 18-24 vjeç. Sa i përket situatës personale ekonomike, efektet e pandemisë më së shpeshti perceptohen si shumë negative nga grup moshat 18-24 vjeç (42%)

dhe 55-64 vjeç (42%), si dhe midis anëtarëve të bashkësive të tjera etnike (56%) krahasuar me maqedonasit (32%) dhe shqiptarët (27%).

Grafiku 67. Perceptimet për efektet e pandemisë




# Preferencat ideologjike dhe të vlerave të qytetarëve

## Vetë pozicionimi majtas përkundër djathtas

Duke përdorur të njëjtën shkallë si më parë, ku 0 do të thotë “majtas” ndërsa 10 do të thotë “djathtas”, qytetarëve iu kërkua të pozicionoheshin në boshtin ideologjik. Gati një e treta (32%) e të anketuarve ose nuk kanë dëgjuar për ndarjen ideologjike nga e majta në të djathtë (11%), ose nuk dinë se ku ta vendosin veten në shkallë (21%) (Grafiku 68). Nga ata që dinin të pozicionoheshin (N=653), mostra përputhet pjesërisht në të djathtë (mesatarja 5.9).

Grafiku 68. Vetë pozicionimi në shkallë majtas-djathtas




Në mënyrë më të detajuar, nga të anketuarit që dinin të pozicionoheshin, 22% zgjedhën qendrën; 28% të majtën (vlerat e zgjedhura nga 0 në 4 në shkallë), dhe 50% të djathtë (vlerat 6-10 në shkallë). Mund të konkludohet se qytetarët e Maqedonisë së Veriut po pozicionohen më shumë drejt "së djathtës".

Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të shprehin qëndrimin e tyre për debatin ideologjik midis të majtës dhe të djathtës në lidhje me rolin e shtetit social, përkatësisht qëndrimin e së majtës se nevojiten tatime më të larta dhe më shumë shërbime sociale, në krahasim me atë të së djathtës tradicionale që avokon për tatime më të ulëta, me çmimin e më pak shërbimeve sociale.

Në raport me këtë shkallë, mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve (N=1004) është 4.6 (Grafiku 69). Në mënyrë më të detajuar, 22% janë vendosur në pozicionin qendror, 40% kanë marrë një pozicion në të djathtë të shkallës, përkatësisht janë në favor të tatimeve më të ulëta dhe më pak shërbime sociale, ndërsa 37% dëshirojnë tatime më të larta dhe më shumë kushte sociale. Kjo do të thotë që, në nivelin e të gjithë mostrës, të anketuarit anojnë pak drejt pozicionit të djathtë ideologjik.

Grafiku 69. Shkalla ideologjike majtas-djathtas, tatimet dhe shërbimet sociale\*




Korrelacioni i përgjigjeve të të anketuarve ndaj këtyre dy pyetjeve për vetë-pozicionimin ideologjik është pozitiv dhe statistikiisht i rëndësishëm, por i vogël ( $r=0.12$ ;  $p<0.01$ ). Sipas këtyre rezultateve, ka mospërputhje midis qëndrimeve të subjekteve. Në numrin e vogël të rasteve kur vetë-pozicionimi ideologjik është një parashikues i qëndrimit të të anketuarve në lidhje me tatimet, parashikimi është në drejtimin që të majtët e orientuar të mbështesin një pozicion të krahut të djathtë në lidhje me tatimet, dhe anasjelltas.

## Pikëpamje mbi barazinë gjinore

Gjysma e qytetarëve të Maqedonisë besojnë se gratë janë të përfaqësuara në politikë në Kuvend në një përqindje të mjaftueshme. Pak më shumë se një e treta e të anketuarve mendojnë se shkalla aktuale e përfaqësimit është ende shumë e ulët (Grafiku 70).

Grafiku 70. Pikëpamjet mbi përfaqësimin e grave në Kuvend






Dallimet gjinore janë jashtëzakonisht të rëndësishme në përcaktimin e kësaj pikëpamje: ndërsa burrat në shumicë besojnë se përqindja është e mjaftueshme (61%) i njëjtë është rasti me një përqindje shumë më të vogël të grave (41%). Burrat në një përqindje më të lartë besojnë se përqindja është shumë e lartë (11%) krahasuar me gratë (2%), dhe gratë, anasjelltas, se përqindja është shumë e ulët (pothuajse gjysma, 49% gra, kundrejt 22% burra).

Të anketuarit nga rajoni Jugperëndimor janë më të spikaturit sipas përgjigjes se përqindja aktuale është shumë e lartë: deri në 17% e tyre u përgjigjën kështu, krahasuar me 2%-8% në rajone të tjera. I njëjti rajon theksohet edhe nga përqindja e të anketuarve që dhanë përgjigje të kundërt – se përqindja është shumë e ulët: 47%, pasuar nga të anketuarit në rajonin Juglindor (43%), rajonin e Pollogut (39%) dhe rajonin e Shkupit (37%). Shumica e qytetarëve në rajonet Lindore (72%), Pellagoni (65%) dhe Vardar (62%) mendojnë se përqindja është e mjaftueshme. Të anketuarit nga zonat rurale në krahasim me të anketuarit nga qytetet më shpesh e konsiderojnë përqindjen aktuale si shumë të lartë (9% kundrejt 5%).

Për sa i përket moshës, vetëm të anketuarit e moshës 35-44 vjeç ishin më të spikatur në pikëpamjen e tyre se përqindja ishte shumë e ulët (42%), ndërsa 60% e subjekteve më të vjetër (65+) e konsideruan atë të mjaftueshme. Maqedonasit (36%) dhe shqiptarët (36%) në një masë më të madhe se të tjerët (24%) besojnë se përqindja është shumë e ulët.

Në kontekstin e barazisë gjinore, të anketuarve iu kërkua gjithashtu të vlerësojnë se kush është më i përshtatshëm për të udhëhequr vendin në kohë krize ekonomike ose shëndetësore (siç është pandemia COVID-19) (Grafiku 71). Për shumicën e të anketuarve (pothuajse gjysma), burrat dhe gratë janë njësoj të përshtatshëm për të udhëhequr vendin. Për vetëm një në dhjetë të anketuar, ata janë gjithmonë burrat, dhe për një përqindje të ngjashme, ato janë gratë. Një ndryshim i caktuar shihet në modalitetin "kryesisht gra/burra", ku burrave u jepet një avantazh disi më i madh ndaj grave në të dy llojet e krizave (diferenca prej 8%-10%).

Grafiku 71. Pikëpamjet nëse burrat apo gratë janë më të përshtatshëm për të udhëhequr në kohë krize




## Mbështetje për rendin politik demokratik

Megjithëse qytetarët në përgjithësi e shohin funksionimin e sistemit demokratik dhe institucioneve me kritika, ata ende shprehin mbështetje relativisht të lartë për dy nga katër masat për besim dhe mbështetje për demokracinë si një formë e rendit politik që janë në dispozicion në sondazh. Në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk pajtohem aspak" dhe 5 "pajtohem plotësisht", qytetarët preferojnë rregullimin demokratik si më të mirin me një mesatare prej  $M=3.7$ , dhe madje edhe më shumë pajtohen, me një mesatare prej  $M=3.9$ , që gjykatat duhet të jenë në gjendje të ndalojnë qeverinë të veprojë jashtë juridiksionit të saj (Grafiku 72).

Mbështetja për demokracinë si forma më e mirë e rregullimit është më e larta në mesin e të anketuarve në rajonin e Vardarit ( $M=4.5$ ) dhe Pellagonisë ( $M=4$ ), dhe më e ulëta në mesin e të anketuarve nga rajoni i Shkupit ( $M=3.4$ ) dhe rajoni i Pollogut ( $M=3.4$ ). Të anketuarit që jetojnë në qytete në një masë më të madhe ( $M=3.7$ ) pajtohen me këtë deklaratë, krahasuar me të anketuarit nga zonat rurale ( $M=3.6$ ), si dhe të anketuarit në tre grup moshat midis 25-54 vjeç ( $M=3.8$ ) krahasuar me të tjerët. Mbështetja për demokracinë është më e lartë midis maqedonasve ( $M=3.8$ ) krahasuar me shqiptarët ( $M=3.5$ ) dhe komunitetet e tjera etnike ( $M=3.6$ ).

Grafiku 72. Mbështetje për rendin politik demokratik



Pohimi se gjykatat duhet të jenë në gjendje të ndalojnë qeverinë të veprojë jashtë juridiksionit të saj ka mbështetjen më të madhe në rajonin e Vardarit, rajonin Jugperëndimor dhe të Pellagonisë ( $M=4.2-4.7$ ), si dhe midis anëtarëve të komuniteteve të tjera etnike ( $M=4.1$ ), krahasuar me maqedonasit ( $M=4$ ) dhe shqiptarët ( $M=3.6$ ).

Dy pohimet e tjera të matura kanë një marrëdhënie të kundërt me demokracinë dhe pëlqimi ndaj tyre mund të konsiderohet si një pozicion që është në kundërshtim me parimet demokratike. Këtu, qytetarët demonstrojnë një shkallë më të ulët të pëlqimit. Pohimi se liderët e fortë në pushtet janë të nevojshëm dhe me koston e thyerjes së rregullave mori një rezultat mesatar prej 2.6, dhe pohimi se politikat për të rritur përfaqësimin e grave në politikë kanë shkuar shumë larg mori një rezultat mesatar prej 2.7.

Mbështetja për një udhëheqës të fortë është më e larta në rajonin Jugperëndimor ( $M=3.4$ ) dhe Juglindor ( $M=3$ ), dhe më e ulëta në rajonin e Pellagonisë ( $M=2.3$ ). Pëlqimi është më i lartë tek burrat ( $M=2.8$ ) sesa tek gratë ( $M=2.6$ ). Pajtimi me pohimin se politikat për rritjen e përfaqësimit të grave kanë shkuar shumë larg është më e larta në rajonin Jugperëndimor ( $M=2.9$ ) të Vardarit ( $M=2.8$ ) dhe të Pollogut ( $M=2.8$ ). Burrat më shumë se gratë u pajtuan me

pohimin (M=2.9 kundrejt 2.4), ashtu si të anketuarit që jetojnë në fshat krahasuar me ata në qytet (M=2.7 kundrejt 2.6).

## Kush ta udhëheqë vendin në vend të politikanëve të zgjedhur?

Një qëndrim pozitiv ndaj mundësisë që aktorë të tjerë të udhëheqin vendin më mirë sesa politikanët e zgjedhur mbizotëron midis qytetarëve (Grafiku 73). Në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk pajtohem aspak" dhe 5 "pajtohem plotësisht", pëlqimi më i lartë për drejtimin e vendit u mor nga ekspertët të pavarur (M=3.6) dhe vetë qytetarët në referendume (M=3.6), dhe mbështetja është më e ulët për liderët e suksesshëm të bizneseve (M=3.3).

Grafiku 73. Kush ta udhëheqë vendin në vend të politikanëve të zgjedhur?



Të anketuarit nga rajoni lindor kanë një shkallë të lartë pajtimi me tre pohimet, ku më e madhja është ajo me vetë qytetarët në referendume. Ka gjithashtu pajtueshmëri të lartë me pohimin e fundit midis të anketuarve nga rajoni Verilindor. Në mesin e të anketuarve nga rajoni i Vardarit, ekziston pajtueshmëri e lartë me mundësinë që ekspertët e pavarur dhe udhëheqësit e suksesshëm të biznesit më mirë të udhëheqin me vendin. Më i ulët është pajtimi në lidhje me udhëheqësit e suksesshëm të biznesit në rajonin Verilindor (M=2.8) dhe rajonin e Shkupit (M=3).


Të anketuarit nga qytetet kanë një mendim më pozitiv për ekspertët e pavarur (M=3.8), krahasuar me të anketuarit nga fshatrat (M=3.4). Burrat, nga ana tjetër, pajtohen më shumë me mundësinë për demokraci të drejtpërdrejtë përmes referendumeve (M=3.7) krahasuar me gratë (M=3.5). Maqedonasit pajtohen më shumë me idenë të udhëheqin ekspertët të pavarur (M=3.8) sesa që pajtohen me këtë shqiptarët (M=3.3) dhe të tjerët (M=3.6), si dhe me idenë e udhëheqjes së vendit përmes referendumeve (maqedonasit japin notë mesatare prej 3.7, krahasuar me 3.2 nga shqiptarët dhe 3.6 të tjerët).

# Predispozitat qytetare për pjesëmarrje politike

## Interesi për politikën


Qytetarët maqedonas nuk janë veçanërisht të interesuar për politikën (Grafiku 74). Vetëm pak më shumë se një e treta e të anketuarve (36%) u përgjigjën se ishin shumë ose disi të interesuar për politikën dhe pjesa tjetër se ishin pak të interesuar (35%) ose aspak (28%). Interesi ishte më i lartë midis të anketuarve nga rajoni Jugperëndimor (11%) dhe Juglindor (11%) ndërsa mosinteresi (mosinteresi i plotë) midis të anketuarve nga rajoni Verilindor (42%) dhe lindor (36%).

Grafiku 74. Interesi për politikën




Gratë tregojnë mosinteresi më të madh për politikën sesa burrat: madje një e treta e grave nuk janë të përfshira aspak kundrejt një të katërtës së burrave (Grafiku 75). Ndër grup moshat, më të rinjtë (18-24 vjeç) treguan mosinteresimin më të madh: gati gjysma e të anketuarve më të rinj ishin fare të pa interesuar (Grafiku 76). Maqedonasit dhe shqiptarët më shpesh janë përgjigjur se janë shumë të interesuar për politikë sesa anëtarët e bashkësive më të vogla etnike (përkatesisht 7%, 8% dhe 1%), ndërsa pothuajse gjysma e të anketuarve që u përkasin bashkësive të tjera etnike nuk janë të interesuar fare për politikë (43% krahasuar me 26% maqedonas dhe 25% shqiptarë).

Grafiku 75. Interesi për politikën sipas gjinisë




Grafiku 76. Interesi për politikën, sipas grup moshës



## Perceptimet për efikasitetin politik personal (të brendshëm)


Gati gjysma e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht me pohimin se i kuptojnë çështjet më të rëndësishme politike në vend (43%), ndërsa më shumë se një në katër të anketuar nuk pajtohen (27%) (Grafiku 77). Vetëm afërsisht një në dhjetë subjekte pajtohen plotësisht (11%) ose nuk pajtohen aspak (10%), ndërsa përgjigjet kryesisht u grupuan në mesataren e shkallës së pajtueshmërisë.

Grafiku 77. Efikasiteti politik i brendshëm




Perceptimet për efikasitetin e lartë politik të brendshëm janë më të larta tek burrat sesa tek gratë (Grafiku 78) ndërsa më të ulëta në grup moshën më të re (18-24) sesa te të tjerët (Grafiku 79). Pothuajse dyfishi i përqindjes së burrave pajtohen plotësisht me deklaratën (14% kundrejt 8% e grave), një përqindje më e lartë dhe pjesërisht pajtohen (36% kundrejt 24%), ndërsa gratë në përqindje dukshëm më të larta nuk pajtohen (21% kundrejt 14% burra – deri diku dhe 13% kundrejt 6% burra nuk pajtohen aspak).

Grafiku 78. Efikasiteti politik i brendshëm, sipas gjinisë



Midis grup moshave, asnjë subjekt nga më të rinjtë (18-24) nuk u pajtua plotësisht me pohimin ndërsa dhe shkalla e pëlqimit të pjeshëm ishte dukshëm më e ulët (22%) sesa të gjitha grup moshat (33% -44%) me përjashtim të më të moshuarve (65+: 23%). Gjithashtu, grupi më i ri (16%) dhe më i vjetër (15%) kryesisht nuk ishin dakord me pohimin (5.5%-8% në grupet e tjera).

Grafiku 79. Efikasiteti politik i brendshëm, sipas grup moshës




Shkalla e pajtimit të plotë është gjithashtu më e lartë në rajonin Jugperëndimor (27%) krahasuar me rajonet e tjera (0%-17%, asnjë i anketuar në rajonin e Vardarit nuk ishte plotësisht dakord me kërkesën), si dhe te ata që jetojnë në zonat urbane krahasuar me ato rurale (13% kundrejt 8%).

## Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve


Për dy të tretat e të anketuarve, përkatësisht 66%, zgjedhjet në vend janë shumë ose disi të rëndësishme (Grafiku 80).

Grafiku 80. Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve\*



Zgjedhjet janë më të rëndësishmet për të anketuarit nga rajoni Lindor (82%), Jugperëndimor (66%) dhe ai i Shkupit (67%) (Grafiku 81). Për 54% të banorëve të rajonit të Vardarit, zgjedhjet janë disi të rëndësishme, ndërsa për 28% të tjerë janë shumë të rëndësishme, gjë që gjithashtu i vendos ata në grupin e rajoneve ku zgjedhjet janë me rëndësi mbi mesataren. Të anketuarit nga rajonet e Pollogut (29%), Pellagonisë (26%) dhe Verilindjes (23%) i vlerësuan zgjedhjet në një masë më të madhe si deri diku të parëndësishme. Në masën më të madhe, zgjedhjet në rajonin Jugperëndimor (19%), të Pollogut (19%) dhe rajonin Juglindor (19%) dhe në rajonin e Shkupit (17%) nuk janë aspak të rëndësishme.

Grafiku 81. Pikëpamjet mbi rëndësinë e zgjedhjeve, sipas rajonit\*



Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për një numër më të madh të të anketuarve nga qytetet (31%) krahasuar me të anketuarit nga fshatrat (25%). Një e treta (33%) e burrave


gjithashtu u përgjigjën se zgjedhjet ishin shumë të rëndësishme, krahasuar me një të katërtën (24%) e grave.

Ndërsa për 33% të maqedonasve dhe 24% të shqiptarëve zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, vetëm 15% e anëtarëve të komuniteteve më të vogla etnike dhanë një përgjigje të tillë. Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për një numër më të madh të anketuarve nga grup moshat 25-54 vjeç (27%-36%) dhe mbi 65 vjeç (32%). Ato janë deri diku më pak të rëndësishme për dy grup moshat e tjera: 18-24 vjeç (28%) dhe 55-64 vjeç (22%).

## Frekuenca e votimit në zgjedhje

47% e të anketuarve nga kjo mostër rregullisht, gjegjësisht gjithmonë dalin në zgjedhje, ndërsa 30% shtesë shpesh dalin në zgjedhje (Grafiku 82). Të anketuarit nga rajoni Verilindor më pak dalin rregullisht në votime: 25% e tyre dalin rrallë, dhe 9% asnjëherë. Pasivitet i lartë vërehet edhe nga të anketuarit nga rajoni i Pollogut (21% votojnë rrallë dhe 9% asnjëherë). Çdo i dhjeti i anketuar nga rajoni i Shkupit nuk voton kurrë, dhe 13% rrallë.

Grafiku 82. Frekuenca e votimit në zgjedhje\*



Ndërsa burrat raportuan në përqindje më të lartë se votojnë gjithmonë (53% kundrejt 42%), gratë raportuan përqindje më të lartë se votojnë shpesh (34% kundrejt 26%). Votuesit më të rregullt janë votuesit e kategorisë së moshës 45-54 vjeç (56%), si dhe maqedonasit (52%) krahasuar me shqiptarët (40%) dhe anëtarët e bashkësive të tjera etnike (33%), të cilët, nga ana tjetër, kanë më pak gjasa të votojnë.



**Titulli:**

Hulumtim krahasues i sistemeve zgjedhore. Gjetjet fillestare për Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me zgjedhjet e prillit dhe majit 2024

**Autorë:**

Doc. Dr. Jovan Bliznakovski  
Prof. Dr. Aneta Cekiq

**Redaktor:**

Doc. Dr. Jovan Bliznakovski

**Botues dhe përpunim grafik:**

Instituti për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi"  
në Shkup (IHSPJ - UKM)

**Për botuesin:**

Prof. Dr. Bojana Naumovska, drejtor i Institutit për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike

**Vendi dhe viti i botimit:**

Shkup, 2025

